



D R I T A

“Drita lufton kundër errësirës kur ndriçon.”

KEPPLER

E PËRMUAJSHME FETARE - KULTURORE E KISHËS KATOLIKE

Prizren • Shtator 2009 • Viti XXVI • Nr. 9 (179) • Çmimi: Kosovë 1€, Europë 2€, Zvicër 3\$FR, SHBA \$2.50



Papa në Republikën Çeke për një Evropë të bashkuar shpirtërisht

FAQE 5

Përgatiti:
DON PAL TUNAJ



Mons. Simon Filipaj, 10-vjetori i vdekjes

FAQE 10-11

Përgatiti:
DON NOSH GJOLAJ



Shën Gjon Vianney meshtarë sipas Zemrës Hyjnore

FAQE 16

Shkruan:
DON ALBERT DEMAJ



Feja – kërkim, shpresa – veprim, dashuria – flijim dhe dhurim

Don Lush GJERGJI

Gonxhe Bojaxhiu u lind në Shkup më 27 gusht 1910 nga prindërit shqiptarë katolikë Kolë Bojaxhiu dhe Drane lind. Bernaj – Bojaxhiu, me prejardhje nga Prizreni dhe Novosella e Gjakovës. Pra, më 27 gusht 2009, sivjet ajo i mbushi 99 vjet dhe tani kemi filluar edhe VITIN JUBILAR – 100-vjetorin e lindjes së saj, të cilin shpresojmë se do ta kurorëzojmë edhe me ndërtimin e Katedrales dhe Shenjtërores kushtuar asaj në Prishtinë.

Në jetën dhe veprën e Nënës Tereze kemi tri faza bazore jetësore që mund t'i dallojmë dhe quajmë edhe me tri emërtime: Gonxhe Bojaxhiu (1910 – 1928), Motra Tereze e Loretos (1929 – 1950) dhe Nëna Tereze – Misionare e Dashurisë (1950 – 1997).

Këto tri periudha jetësore kanë tri qëndrime apo orientime, përcaktimi meqenëse që përpunohen me tri virtyet themelore të jetës së krishtetë: FEJA, SHPRESA dhe DASHURIA.

Faza e parë 18-vjeçare karakterizohet me KËRKIME. Gonxhja së pari në gjirin e saj familjar gjithnjë kërkonte prej prindërve babës Kolë dhe nënës Drane – kuptimin e jetës dhe domethënien e veprimit. Më vonë këtë kërkim e kishte vazhduar edhe në bashkësinë famullitare të “Zemrës së Krishtit” në Shkup, së bashku me rininë katolike, por edhe me të gjithë të tjerët, sidomos me meshtarët e atëhershëm.

Ja dëshmia e saj: “Isba ende shumë e re, pa i mbushur 12 vjet, e rrethuar nga familja, kur ndjeva dëshirën e parë për t’u dhënë tërësisht Zotit. Gjashtë vjet kam medituar dhe jam lutur... Në fillim nuk më pëlqente fare ky mendim, “tundim”. Disa herë kam menduar se isha liruar nga kjo dëshirë... Ndonjëherë më dukej se po bëja gabim, se kjo nuk ishte thirrje, por më në fund u binda se isha e ftuar nga Zoti. Zonja e Letnicës, Zonja Çernagore, më ndihmoi shumë për ta arritur një vendim të tillë”.

Dhe kjo fe, ky kërkim nuk u ndërpre më askurrë. Kërkonte vullnetin e Zotit, Zotin, nëpërmjet njeriut, dhe në njeriun vëlla – motër – ZOTIN. Për Nënë Tereze të besosh domethënë të kërkoesh.

Faza e dytë jetësore e Nënës Tereze karakterizohet me veprim sipas stilit dhe porosisë së Jezu Krishtit i cili thotë: S’kam ardhur të më shërbejnë, por të shërbëj dhe ta dhuroj jetën time për shëlbimin e botës. Për afro 20 vite e mësonte rininë e Kalkutës, i edukonte me fjalë, mësim, shembull, jetë gjithnjë e udhëhequr nga fuqia e fesë dhe nga frymëzimi i dashurisë.

Dhe ja prapë dëshmia e saj: “Si fluturon koha këtu. Kur ndalem dhe mendoj për thirrjen time misionare, mund të them vetëm një FALËNDERIM të madh e të përzemërt, Ty o Zoti, që më ke dashur aq shumë dhe që më ke dhënë mundësinë e dashurisë së përkujdesjes ndaj të tjerëve” (Nga letra vëllaut Lazër në viti 1937).

Nga kjo fe – kërkim – shqetësim kreativ, nga ky veprim – shërbim që ishte shpresa e saj e madhe dhe e pathyeshme, lindi edhe faza e tretë: NËNA TERZE – MISIONARE E DASHURISË, dhurimi dhe flijimi si shprehje e vazhdueshme dhe e plotë e Dashurisë. Kërkimi (feja), veprimi (shpresa) dhe dhurimi (dashuria) ishin dhe mbeshin shtyllat në të cilat ajo e mbështeti mbarë jetën dhe tërë veprim – flijimin për ta mahinur njerëzimin si Nëna e Dashurisë, së shpejti shpresojmë dhe urojmë SHENJTËRESHA E DASHURISË. Ajo shkruante kështu: “Vetëm duke dhënë njeriut merr;

Vetëm duke harruar vetveten, njeriu e gjen veten;

Vetëm duke falur njeriut është i falur;

Vetëm duke dashuruar njeriun gjen jetën dhe lumturinë”.

Së bashku me Nënë Tereze edhe ne do të besojmë në Zotin dhe në Njeriun, do ta kërkojmë njeriun vëlla ose motër, për t’u takuar, afëruar, vëllazëruar dhe bashkuar në shërbim të të Mirës, të të Drejtës, të Vërtetës, mbi të gjitha të Dashurisë. Nëna Tereze me ZOTIN – DASHURINË dhe me VËLLAUN – NJERI bërë vërtet mrekulli si binom i pandashëm i jetës dhe veprimit të saj të madh në të gjitha meridianet e botës. Risia e vjetër dhe gjithnjë e re është feja, shpresa dhe dashuria, që për Nënë Tereze ishin kërrimi, veprimi dhe dhurimi, mundësi dhe fuqi për ta ndërruar së pari vetene, pastaj të tjerët, dhe së bashku, vëllazërisht edhe botën tonë kaq të ngarkuar, të rënduar, të plagosur historikisht nga robëria, sundimi i it e huajve, dhe aktualisht nga egoizmi, egocentrizmi, hedonizmi apo shthurja morale, interesi, materializmi, indiferentizmi, ateizmi praktik...

Këtë ia kemi borxh Nënës Tereze, vetvetes, të tashmes dhe ardhmërisë sonë.

Muzika shqiptare (vështrim i shkurtër)

FAQE 14

Shkruan:
Prof. mr. Vinçenc GJINI

Intervistë me Hirësinë e Tij kardinalin Jose’ Saraiva Martins, Prefekti i Kongregatës për Shpalljen e Shenjtëve në Romë

Nënë Tereza - ylli dhe pasqyra, të cilën mund ta shikojnë dhe ndjekin të gjithë

FAQE 12-13



Faleminderit at Ilija Kovaçević

Është i lindur më 3 mars 1957, nga prindërit Ante dhe Angje lind. Matković në Kovačev, komuna Derwent, famullia Plehan. Shkollën fillore kreu në Bunar 1971, kurse të mesmen në Gjmnazin Françeskan në Visoko 1971 - 1975.

Zhgunin françeskan e veshi më 15. korrik 1975 në Visoko. Kushtet e para rregulltare i merr më 10 korrik 1976 në La Verna afër Asizit në Itali. Gjatë viteve 1976 - 1982 studioi filozofinë dhe teologjinë në fakultetin Françeskan në Sarajevë.

Kushtet e përjetshme françeskane i mori më 26 prill të vitit 1981, kurse shugurimin xhakonal më 2 korrik të po atij viti në Sarajevë. Në Gjakovë erdhi si xhakoni më 17 prill 1982, para shugurimit meshtarik.

Diçtën e Shën Pjetrit e Palit më 29 qershor 1982, shugurohet meshtar në katedralen e Sarajevës nga argjeshkvi i Sarajevës Mons. Marko Jozinović.



At Ilija dekretohet me shërbim në Gjakovë në vitin 1982 ku do të shërbejë deri në vitin 1988. Atë vit frati kthehet në Bosnje ku për një vit shërben në famullinë Gornja Dubica. Pas një viti, për të dytën herë vjen në Gjakovë më 27.6.1989 ku shërbeu deri në korrik të këtij viti. Shërbeu gati në të gjitha filiallet e famullisë së Gjakovës. Gjatë viteve 1991 - 1997 frati ishte guardian i Kuvendit françeskan si dhe famullitar i famullisë së Gjakovës. Në atë kohë e përfundoi ndërtimin e Kuvendit të ri Françeskan, pranë kishës së Shën Antonit dhe

e rinovoi Kishën e Shën Antonit (1996).

Frati gjatë shërbimit të tij në Gjakovë ka organizuar disa kuize ndër-famullitare katekistike. Përgatiti dhe botoi disa fletore pune për mësim feje: për kl. V (2001), kl. VI (2002), për fillestarë (2003), për kl. II. (2004), ishte iniciator i botimit të revistës "Bashkësia jonë" - dhe redaktor teknik i saj. Është bashkëpunëtor i "Dritës" dhe anëtar i redaksisë së revistës "Jeta liturgjike". Po ashtu është nismëtar i web faqes së famullisë së Gjakovës www.kisha-katolike-gjakove.com

Në korrik të këtij viti frati dekretohet me shërbim në Plehan afër Derventes.

Patër Ilija shërbeu 28 vjet në mesin e popullit tonë. Frati i dëshirojmë gjithë të mirat në jetë dhe e falënderojmë për shërbimin ndaj Zotit, Kishës dhe popullit shqiptar.

Shpresoj të kthehet përsëri në mesin tonë. Zoti të bekoftë!

(M.R.)

Mirë se erdhët at Mijo Shuman

Pas emërimit të At Lorencit për provincial në Sarajevë, i cili shërbeu 30 vjet popullit tonë, dhe kthimit të At Ilisë në vendlindjen e tij, 28 vjet shërbim në Gjakovë, këtyre ditëve në Gjakovë erdhi frati i ri, At Mijo Shuman.

At Mijo ka lindur më 25 mars 1970 në Travnik, Bosnja qendrore, nga prindërit Anto dhe Mironija lind. Çeko. Frati është nga fshati Billa, famullia e Shën Gjergjit në Vitez. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen në Zagreb. Në vitin 1992 hyn në kuvend, vitin e postullaturës në Bashka Voda në Kroaci. Zhgunin françeskan e veshi në vitin 1993, kurse kushtet e para rregulltare i mori më 27 korrik 1994 në Monopoli, Itali. Studimet filozofike teologjike filloi në Samobor-Zagreb dhe përfundoi në Sarajevë ku diplomoi në temën e teologjisë pastorale.

Më 30 shtator 1998 mori kushtet e përjetshme në kuvendin e lashtë në Fojnica.



Shugurohet meshtar në katedralen e Sarajevës ditën e Shën Pjetrit dhe Palit më 29 qershor 2000 nga kardinali i Sarajevës, imzot Vinko Puljić. Meshën e Parë e kremtoi në shenjtëroren e Kalvarisë në vendlindje.

Si meshtar i ri shërben për tri vite në Dubravë afër Brčkos.

Në vitin 2003 shkoi në Shqipëri, në Fier së bashku me imzot Hil Kabashin, ipeshkëv i Shqipërisë së Jugut. Një vit pas emërohet ndihmës i At Engjëllit në Laç, por

nuk qëndron gjatë aty, sepse Kuria françeskane në Shkodër kërkon që At Mijo të vendoset në Bajzë që të shërbejë në pjesët e Kastratit.

Gjatë këtyre tri viteve frati ka përvetësuar shumë mirë gjuhën shqipe. Në vitin 2006 kapitulli i françeskanëve në Sarajevë vendos që At Mijo të kthehet në Bosnje ku emërohet vikar në kuvendin françeskan në Guça Gora afër Travnikut.

Në korrik të këtij viti, Kuria françeskane në Sarajevë, të cilës i përket edhe bashkësia e fetërve në Gjakovë, dekreton At Mijon me shërbim në Gjakovë.

At Mijos i dëshirojmë mirëseardhje në Gjakovë, shëndet dhe jetë të gjatë.

Fratin e ri dhe gjithë fetërit nga Bosnja që shërbyen në popullin tonë, Zoti i shpërbleftë me të mirat qiellore.

(Merita Raja)

Shën Gjoni Kryepremë në Moglicë dhe Lugbunar

Të shtunën me 29 gusht në Moglicë dhe Lugbunar të Gjakovës u kremtua festa e Shën Gjoni Kryepremë. Ky shenjt ndërohet në Moglicë, Lugbunar dhe fshatrat përreth. Meshën në Moglicë e drejtoi frati i ri i porsaardhur në Gjakovë, patër Mijo Shuman.

Patër Mijo në predikim foli për figurën e Shën Gjoni, i cili edhe pse u dënua me vdekje, nuk i ra mohit të vërtetës dhe ligjit të Zotit. "Ky shenjt foli haptas kundër mëkatit publik që kishte bërë Herodi, mbreti i Izraelit", tha ai ndër të tjera. Figura e Shën Gjoni na tregon se të jesh dëshmitar i Zotit, mund të të kushtojë edhe me jetë, por jeta nuk është më vlefshme se sa e Vërteta. Në duhet të jetojmë me të Vërtetën, në Rrugë që ta kemi Jetën.

Në këtë meshë, edhe pse bente vapë, kishin ardhur numër i madh nga famullia jonë dhe famullitë tjera. Në këtë meshë koncelebruan edhe kapelani ushtarak i KFOR-it Italian, don Salvatore dhe xhakoni i porsashuguruar don Martin Jetishi.

Patër Antoni, famullitar i Gjakovës të gjithëve ju uroi këtë festë dhe i falënderoi për pjesëmarrjen e tyre.

Edhe në filialin e famullisë së Becit, pikërisht në fshatin Lugbunar u bë.

(Dritapress)



nar u kremtua me solemnitete dhe devotshmëri festa e Shën Gjoni kryepremë. Meshën e udhëhoqi bashkëpunëtori baritor në famullinë e "Zojës Ruzare" në Bistrazhin don Tomë Gjurgia. Don Toma, përveçse është bashkëpunëtor në Bistrazhin, ai drejton edhe filjalin e Janoshit, kapele kjo e famullisë së Becit. Në fjalën e rastit don Toma me plot zemër i nxiti besimtarët në ripërtëritjen e fesë dhe u ndihmoi atyre që sa më me përshpirtmëri ta jetojnë këtë ditë feste. Ai i grishi besimtarët që të jetojnë fenë e tyre sipas shembullit të shenjtëve dhe shenjtëreshave të Hyjit e sidomos sipas shembullit të pasqorë të Shën Gjoni. Në fund të meshës don Kelmend Spajić, famullitar i kësaj bashkësie, falënderoi të pranishmit dhe don Tomë Gjurgjin për fjalët e mira që ai i drejtoi. Shën Gjoni kryepremë lutu për ne!



U kremtua në Janosh të Gjakovës Festa e të lumturës Nënës Tereze nga Kalkuta

Arsyeja dhe motivi që mboldhi një numër të konsiderueshëm të besimtarëve në kapelën e fshatit Janosh, që pikërisht festa e kësaj bashkësie të vogël që me shumë hare kremtuan shembullin, jetën dhe sakrificën e pasqorë të së lumturës Nënës Tereze nga Kalkuta. Kjo festë, do të thotë lindja e saj për në qiell, ra pikërisht në 99-vjetorin e lindjes së saj. Vitin e ardhshëm me shumë gëzim e gjithë bota do ta kremtojë 100-vjetorin e lind-

jes, me shpresë edhe me ndërtimin e Tempullit të ri, Katedrales në Prishtinë.

Këtu në Janosh meshën i priu meshtari don Jeton Thaqi, kapelani i famullisë së "Shën Nikollës", në Velezhë. Ai në fjalën e rastit shpjegoi se si Nëna Tereze vazhdimisht është frymëzuar në jetën e saj prej Fjalës dhe Gostisë Hyjnore që për çdo ditë e sidomos të dielave shtrohen për më të "privilegjuarit" - pra për të krishterët. Ai gjithashtu i grishi



besimtarët që mos të mbeten vetëm me atë zakoni e vjetër duke u mburr me Nënën Tereze, por të jetojnë gjallërisht shembullin e saj dhe të jeta dhe sakrifica e saj të jetë rast frymëzimi për jetën e famulleve tona.

Don Tomë Gjurgia, përgjegjësi i kësaj bashkësie i falënderoj të pranishmit dhe në mënyrë të veçantë predikuesin për fjalët e ngrohta. Ai të gjithëve ua uroi këtë festë shumë madhështore.

(Dritapress)

Festa e së lumes Nënë Terezës në Katedralen e Prizrenit

5 shtator 2009 – 5 shtator 2010 viti kushtuar së Lumes Nënë Tereza

Me 5 shtator 2009 në Katedralen tonë të Prizrenit Ipeshkvi ynë mons. Dodë Gjergji në krye me meshtarët, rregulltarët, rregulltarët dhe popullin e Zotit që kishin ardhur nga famulli të ndryshme u bashkuan për të kremtuar festën e së lumes Nënë Tereza.

Në bashkë-meshim ishte i pranishëm edhe mons. Želimir Puljić Ipeshkëvi i Ipeshkvisë së Dubrovniku që kishte ardhur me disa meshtar të Ipeshkvisë së tij për të marrë pjesë në festën e Nënë Terezës dhe për të vizituar disa nga famullitë tona këtu në Kosovë.

Gjatë prektut të rastit Ipeshkëvi mons. Dodë Gjergji foli për figurën e madhe të së lumes Nënë Tereza duke kujtuar epatat më të rëndësishme të jetës së saj.

Nënë Tereza qysh në moshën e re ndjeu dëshirën për të ju kushtuar Zotit në rrugën e rregulltarisë dhe këtë e bëri në vitin 1928, vit ky në të cilin ajo hyri në Institutin e Motrave të Loretës. Pas 20-të viteve në bashkësinë e Loretos ku e ushtroi zemërgjerësinë, bujarinë, guximin, aftësitë e posaçme për të dashur dhe për të shërbyer, në vitin 1946 ajo ndjeu frymëzimin e ri, thirrjen brenda thirrjes, etjen e Krishtit në të varfër dhe në të

Mons. Želimir Puljić, mons. Dodë Gjergji dhe don Fran Kola gjatë kremtimit të meshës



mjerë. Dashuria për ta shuar etjen e Jezusit e pushtoi zemrën e sajë sa që vendosi të hyjë në botën e të varfërve duke themeluar Misionaret e Bamirësisë të cilat edhe sot e kësaj dite vepron në shumë shtete të botës me të njëjtin shpirt dhe dashuri që kishte Nënë Tereza.

Misioni i Nënë Terezës përhapet me të shpejtë në mbarë botën, sa që e tërë bota, në mënyra të ndryshme, filloi ti ngulë sytë në veprën e madhe të bamirësisë që ajo kishte nisur në nder e lavd të emrit të Zotit dhe për të mirën



Grupi i Filharmonisë së Kosovës

dhe lehtësimin e vuajtjes së të varfërve.

Ipeshkvi ynë, përveç tjerash, shtoi se krejt jeta e Nënë Terezës është dëshmi e gjallë se Zoti kryen

vepra të mëdha në ata që e duan dhe besojnë në fuqinë dhe praninë e Zotit në jetën e njeriut, dhe njëkohësisht ftoi gjithë të pranishmit që shembulli dhe dëshmia e kësaj Nënë dhe Gruaje të madhe të jetë udhërrëfyes për të gjithë ne që e duamë, e nderojmë, e respektojmë dhe e lusim ndërmjetësinë e sajë që të na gjendet te Zoti si ndër-

kremtojmë 100 vjetorin e lindjes së sajë, dhashtë Zoti në Katedralen e re në Prishtinë, Ipeshkvi ynë mons. Dodë Gjergji vendosi që nga 5 shtatori 2009 deri me 5 shtator 2010 për Kishën tonë lokale të jetë vit i kushtuar së Lumes Nënë Tereza. Gjatë këtij viti, shtoi ipeshkvi, jemi të ftuar që në mënyra dhe forma të ndryshme të tregojmë dashurinë, nderimin dhe falënderimin tonë për një Grua kaq të madhe e cila lindi nga gjiri i popullit tonë dhe shkoi e u bë Nënë e mbarë botës.

Pas meshe, një grup i Filharmonisë së Kosovës e zmadhoi gëzimin dhe festën me praninë dhe zërin e tyre të mrekullueshëm. Menjëherë pas pikave muzikore, për gjithë të pranishmit ishte përgatitur një kolektiv rast për gjithë të pranishmit në sallën e famullisë së Prizrenit.

Dhashtë Zoti dhe ndërmjetësia e së lumes Nënë Tereza që ky vit të jetë vit hiri dhe bekimi për të gjitha familjet e popullit tonë, në mënyrë që mësimi dhe shembulli i Nënë Terezës të jetë frymëzim edhe për jetën dhe punën tonë të përditshme.

(Don Anton Ukaj)

Dugajevasi kremtuan 99-vjetorin e lindjes së Lumes Nënës Tereze

Me 5 shtator 2009, në fshatin Dugajevë u kremtua në mënyrë solemne 99-vjetori i lindjes së Nënës Tereze. Në Kapelën e fshatit, e cila i është kushtuar Të Lumes Nënës Tereze, e cila është ngritur mbi kodrinën e fshatit (mesha e parë është celebruar më 2 shkurt 2001 nga dr. don Gjergj Gjergji-nismëtar kryesor për ngritjen e kësaj shtëpie të Zotit), duke filluar nga ora 11. Meshën Shenjte e celebroi dr. don Lush Gjergji. Në Meshë dhe shërbesa tjera të përshpirtëshme me këtë rast, morën pjesë një numër i madh meshtarësh të Ipeshknisë sonë dhe më gjerë.

Dugajevasi e ndjenin veten krenarë, të privilegjuar dhe shumë të nderuar me pjesëmarrjen kaq madhështore të meshtarëve dhe Motrave të Nderit, duke përshirë këtu edhe një numër të motrave "Misionaret e Dashurisë" me seli në Pejë, të cilat janë trashëgimtare të denja të themelueses së këtij rendi të motrave - Të Lumturës Nënës Tereze, emrin e së cilës me krenari e mban kjo shtëpi e Zotit. Kënaqësia për besimtarët dugajevasi ishte edhe më i madh, kur u kuptua që meshën do ta udhëheqë shumë i nderuari Don Lush Gjergji, famullitarit të Katedrales së Prizrenit. Don Lushi iu drejtua besimtarëve me këto fjalë: "Të dashtun vëllezër e motra, besimtarë të nderuar, nuk do të duhej të



krenohemi vetem pse Nënës Tereze ishte nga viset tona dhe që i përkiste gjakut tonë, por me vepra të dëshmojmë që jemi në gjendje ta duam njëri-tjetrin, ta duam njeriun në përgjithësi siç i deshi dhe iu përkushtua Ajo njerëzve, të varfërve ndër më të varfër, të sëmurë, të gërburur, të vobektë... me dashurinë më të madhe të zemrës së saj, me dashurinë e Krishtit dhe për Krishtin, sepse Nënës jonë Tereze e kishte në zemër thënien e Krishtit: "Duajeni njëri-tjetrin siç unë ju desha juve"

Ajo ndër të tjera u thoshte "Misionarëve të dashurisë": "...në këtë mënyrë ia tregojmë dhe dëshmojmë Dashurinë tonë Jezu Krishtit, i cili është i fshehur në trajtë të bukës dhe në trajtë të të varfërve..."

Në fund të predikimit të tij Don Lushi iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë: Këtë vit Ipeshkvnia jonë e ka shpallur vit të Nënës Te-

reze, me qenë se është 100-vjetori i lindjes së saj. Prandaj, të shprehim që sot një vit do të kremtojmë përvjetorin e 100-të të lindjes së Nënës tonë të dashur Tereze dhe nënës së botës mbarë, sepse e gjithë bota e quajti me kënaqësi NENË, në Katedralen e Kosovës në Prishtinë, e cila i është kushtuar Së Lumes Nënës Tereze.

Kah përfundimi i meshës administratori i kësaj famullie don Herbert Berisha, i falenderoi don Lushin, meshtarët dhe të gjithë të pranishmit, duke ua uruar nga zemra këtë festë që edhe në vitet e ardhme gjithmonë ky popull të festojë dhe të jetojë në hiri e të madhit Zot. Dhe për të ftuarit don Herberti e shtroj edhe një gosti vëllazore në objektet e kishës në Poterq.

(Don Jeton Thaqi)

Në famullinë e Gllaviçicës frymohet plot jetë e gjallëri

Pjesa e parë e muajit shtator të këtij viti, kaloi në shenjë të shënimit të përvjetorëve dhe kremteve të përshpirtshme në famullinë e Gllaviçicës (Shëngjonit). Ishte kjo një periudhë kohore e shënuar me plot aktivitete dhe gjallëri nga ana famullitarit të kësaj famullie, Don Herbert Berisha, së bashku me besimtarët e fshatrave të kësaj famullie. Në veçanti gjallëria ishte e shprehur në fshatrat Dugajevë dhe Gllaviçicë.

Në Shëngjon (ish-Gllaviçicë) u shënuan tri kremte të njëjtën ditë

Ditën e hënë, më 14 shtator 2009, në Kishën "Lartësimi i Kryqit", në fshatin Shëngjon – ish Gllaviçicë, u kremtua një festë e trefishtë: ishte Dita e Kishës – pajtores së këtij fshati dhe qendrës së famullisë sonë, gjëgjësisht dita e lartësimit apo fitores së kryqit; kisha ishte rinovuar me mjete të besimtarëve të kësaj famullie dhe më gjerë. Me këtë rast u bekua Kisha (renovimi i saj) nga ana e Klerit Katolik të Kosovës në krye me dr. don Lush Gjergjin (në mungesë të Shkël-



qesisë së tij, Ipeshkvi të Ipeshkvisë sonë Imzot Dodë Gjergji, për shkaqe shëndetësore; brezi i radhës i besimtarëve të rinj nga fshatrat që i takojnë kësaj Famullie solemnisht pranuan sakramentit e Krezmimit apo të Përformimit. Meshën gjithashtu e udhëhoqi Dom Lush Gjergji. Me këtë rast morën pjesë një numër i konsiderueshëm i meshtarëve dhe Motrave të Nderit dhe një numër i madh i besimtarëve nga fshatrat përreth dhe më gjerë. E gjithë kjo mundësoi një përjetim të madh si për besimtarët, motrat e nderit për vetë meshtarët, në veçanti për administratorin e kësaj famullie, i cili me shumë zell dhe përkushtim e përgatiti të tërën, bashë me motrat e shën Filip Nerit dhe me shumë vullnetarë.

(Nikollë Gojani)

U kremtua festa e Lindjes së Virgjërës Mari në famullinë e Becit

Më 8 shtator viti për vit Kisha katolike kremton festën e Lindjes së Virgjërës Mari, Nënës së Jezu Krishtit dhe Nënës së mbarë njerëzimit. Tradita e kësaj feste lindi në shekujt e parë në lindje dhe më vonë që Papa Sergji I, në shekullin e VII, ai që e shpalli këtë festë në kalendarin liturgjik të Kishës. Me përkujtimin e kësaj feste, që tradita kishtarë e njëj me emrin "Të lindurit e Zojës", ku kremtojmë ditëlindjen e Virgjërës Mari, Nënës së Zotit, në krahë të cilës në mishërua Jezu Krishti.

Këtë fat për të kremtuar më solemnisht edhe familjarisht e ka famullia e Becit, ku vit për vit bashkohen një numër i konsiderueshëm besimtarësh të ardhur prej të gjitha viseve për t'iu gëzuar lindjes së Zojës së Bekuar. Bashkë me besimtarët e shumtë, në këtë festë morën pjesë edhe shumë meshtarë të ipeshkvisë sonë, të cilët me praninë e vet gjithmonë e shtojnë gëzimin dhe i zmadhojnë



festat. Në dallim me festat tjera, në këtë vit meshës i priu një meshtar italian, misionar në Shqipëri Atë Salvatore, famullitar i famullisë së "Shën Kollit" në Lezhë. Arsyeja e pranisë së tij ishte shumë prekje, sepse kujtonte vitet e vështira të luftës ku shumë besimtarë dhe qytetarë gjetën ndihmë tek famullia e "Shën Kollit" në Lezhë. Ky meshtar, misionar i zellshëm u mundua me gjithë shpirt që këto vuajtje t'i zvogëlojë dhe t'i shuajë sa më shumë duke u kujdesur në mënyra të ndryshme. Prandaj edhe nga ana e famullitarit don Kelmend Spaqi nuk munguan

falënderimet dhe mirënjohjet për mundin, angazhimin dhe sakrificën e tij dhënë besimtarëve dhe qytetarëve të vendit tonë në përgjithësi. Edhe Atë Salvatore, me shumë emocione dhe me pak vështirësi të gjuhës dhe të rrethit të panjohur, shprehi gëzimin e tij dhe me fjalë të mrekullueshme grisi besimtarët që t'i gëzohen lindjes së Nënës së mbarë njerëzimit. Në meshë ishte i pranishëm edhe kapelani i KFOR-it italian dhe ungjillin në këtë rast e lexoi xhakoni Martin Jetishi, i cili vitin e xhakonatit do të kalojë në famullinë e "Shën Rrokut" në Novosellë. Vlen të përmendet se nga famullia e Doblibares, së bashku me motrat e kësaj familje morën pjesë në mënyrë grupore të organizuar rinia e kësaj familje.

Për të gjithë meshtarët dhe motrat u shtrua një drekë e begatë nga ana e famullitarit. Mirë u pafshim në festat e tjera të famullisë!

(Dritapress)

Lindja e Zojës u kremtua edhe në Gurakoc të Istogut

Edhe në Gurakoc të Istogut, kapelle kjo e famullisë së Zllakuqanit, kremtua festa e lindjes së Zojës së Bekuar. Si në vitet e tjera edhe kësaj here një mori e madhe e besimtarëve bashkuar për të kremtuar këtë festë duke marrë pjesë aktivisht në Gostinë e Fjalës dhe të Eukarishtës shenjtë.

Meshën kryesore dhe të vetmen në ora 11:00 u udhëhoqi famullitari i "Shën Mhillit në

Doblibare don Kolë Thaqi. Don Kola tashmë i njohur edhe tek populli për aftësitë e tij oratorike e shumë popullore, do të thotë, të afërta me mendësinë e besimtarëve, u predikoi në këtë rast me shumë vull dhe entuziazëm, duke u përqendruar kryesisht në edukimin e të rinjve dhe të rejave që mos të keqpërdorin mjetet dhe teknikat moderne për shkatërrimin dhe degradimin e

jetës familjare dhe mos të bien pre e mas-medieve, reklamave e publicitetit që e kanë interesin e tyre të përfuturit e jo të mirën e njeriut. Edhe famullitari i kësaj bashkësie don Izak Dodës, uroi të gjithëve festën dhe e falënderoi don Kolën për fjalët e mira. Edhe kori i kësaj filiale e shtoi pa masë gëzimin e kësaj feste. Për shumë vite!

(Dritapress)

Përvjetori i 25-të i meshtarisë i pater Anton Nua

Të martën më 22 shtator Bashkësia e frerëve në Gjakovë pati një festë të veçantë, ku gvardiani dhe famullitari i Gjakovës e festoi 25 vjetorin e meshtarisë së vet.

Në meshën shenjtë ishin të pranishëm një numër i madh i besimtarëve dhe shumë meshtarë e motra të nderit.

Predikimin e rastit e mbajti pater Engjëlli, i cili për shumë vite kishte shërbyer në këtë famullitë.

Pater Engjëlli në fjalën e rastit çmoi lartë kontributin dhe bashkëpunimin e mirë që pater Anton tregoi gjatë 25-së viteve meshtari.

Të pranishëm në këtë festë ishin edhe provinciali i Provincës Françeskane të Bosnës pater Lorenci dhe provinciali i Provincës Françeskane të Shqipërisë pater Gazmend Tinaj si dhe don Lush Gjergji, vikar gjeneral i Ipeshkvë-



visë së Kosovës.

Menjëher pas meshe meshtarët, rregulltarët, rregulltarët dhe familja e ngushtë e pater Antonit vazhduan gëzimin e kësaj feste në sofrën vëllazërore të shtruar nga etërit françeskan; fëmijet e famullisë gjatë drekës e shfaqën një program të shkurtër që e kishte përgatitur enkas për këtë manifestim.

Pater Antonit, në emër të Redaksisë, i urojim edhe shumë vite tjera të begatshme dhe të shenjtë në shërbimin meshtarak. Urime!

(Dritapress)

Famullia e Doblibares kremtoi kryeengjëjt Mihaelin (Mhillin), Gabrielin dhe Rafaelin

Më 27 shtator 2009 famullia e Doblibares kremtoi festën e pajtorit të saj Shën Mihaelit (Mhillit) Rafaelit, Gabriellit. Meshën e celebri At Anton Nua, ku në bashkëmesim ishin dhe vëllezërit tjerë meshtarë të famullive të ndryshme. Bukurinë e kësaj feste ia dhuroi dhe numri i madh i besimtarëve, të cilët morën pjesë në meshën shenjtë, gjithashtu edhe kori i të rinjve si dhe kryetari i komunës z. Pal Lekaj.

Kjo festë e vogël që festohet në një famullitë të vogël, por e ka vlerën mjaft të madhe. Ja një përmbledhje të shkurtër rreth kësaj feste:

Kështu Mikel (Mihael) do të thotë: Kush është si Hyji?, Gabriel: Forca e Hyjit, dhe Rafael: Ilaci i Hyjit.

Kur duhet të ndodhë diçka që kërkon guxim dhe forcë të madhe, thuhet se dërgohet Mikeli, në mënyrë që të mund të kuptohet, nga veprimi dhe nga emri,

Përrurimi i Ordinariatit Ipeshkvor dhe Qendrës shumë funksionale në Prishtinë

Më 11 shtator 2009 u përrurua Selia e re Ipeshkvore në Prishtinë. Kisha në Kosovë pati një gëzim të veçantë dhe me të drejtë mund të thuhet se kjo ditë për Kishën në Kosovë ishte një ditë historike. Pikërisht në këtë

rahim Rugovës dhe Imzot Mark Sopit, të cilët kanë vënë gurthemelin e kësaj Katedrale, nuk do të kishim sot Tempullin e kushtuar Nënë Terezës. Ai gjithashtu ka falënderuar Pater Dietrich Demuth, Drejtorin Ekzekutiv të Renovabis-it, të cilët kanë mbështetur 70 për qind të punimeve në Rezidencën e re.

Atmosfera ishte shumë festive, në prani të një numri të madh të besimtarëve, që kishin ardhur nga të gjitha famullitë e Kosovës, pastaj autoritetet vendase dhe ndër-



ditë kur është përmbyllur faza e parë e ndërtimit në kompleksin e Katedrales në Prishtinë, është bërë përrurimi dhe bekimi i Selisë së re - Qendrës shumë funksionale të Administraturës Apostolike të Prizrenit në Prishtinë. Ritin e bekimit e bëri Imzot Zef Gashi, Arqipeshkvi i Tivarit, ndërsa shiritin e preu Imzot Dodë Gjergji dhe (përfaqësuesi i Renovabisit).

Gurthemelin për ndërtimin e Katedrales e patën vënë tashmë të ndjerët Presidenti Ibrahim Rugova dhe Imzot Mark Sopit, më 26 gusht të vitit 2005.

Me rastin e përrurimit Ipeshkvi i Kosovës Imzot Dodë Gjergji, theksoi se pa ndihmën e Dr. Ib-

kombëtare.

Të pranishmit vizituan edhe punimet e Katedrales e të së Lumës Nënë Tereze, me shpresë që 100-vjetori i lindjes së saj të ketë mundësi të përfundojë në kishën e kompletuar. Në fund ishte përgatitur një kolekt për të gjithë të pranishmit.

(Don Albert JAKAJ)



(M. Marki)

Romë - Përfundoi Kapitull i Përgjithshëm Misionarëve Kumbonianë: "Rithemelim, rikualifikim, riprogramim"

Përfundoi Kapitulli i Përgjithshëm i Misionarëve Kumbonianë, i cili u mbajt në Romë, në shtëpinë gjenerale të themeluar nga Shën Daniel Kumboni. Hapja e kapitullit u bë me Meshën Solemnë të udhëhequr nga kardinali Ivan Dias, perfekt i Kongregatës për Ungjillëzimin e Popujve. Eprori gjeneral e ka koncentruar kapitullin në tri pika: "Rithemelim, rikualifikim dhe në riprogramim të Institutit". "Rithemelimi – duhet të kuptohen radikalizmi në Jezu Krishtin, në Fjalën e Zotit dhe në statusin kombonian, me qëllim që të transformojmë jetën ashtu sikur themeluesi ynë që ishte një person i thjeshtë veronez dhe u bë një person universal duke e mishëruar e fjalën e Zotit. "Rikualifikim – duhet t'i japim kualitetet me të madh jetës nëpërmjet misionit tonë, me shumë radikalizëm dhe vlerësim në detyrat e dinjitetit të personit që i mbrojnë fjalën e Zotit. Kohërencë dhe radikalizëm, sepse një-ritëz presin nga ne të dhurojmë



një stil të jetës nën udhëheqjen e Fjalës së Zotit. Të ngrisin zërin me slogane nuk mjafton, por kërkohet edhe duresa ungjillore. "Riprogramim – prezenca jonë dhe detyrat që i kërkon Rregulli i jetës Komboniane, pra duke i privilegjuar të varfrit dhe të braktisurit e katër kontinenteve, me më shumë kujdes Afrikën, ato vende në cilat njeriu modern dëshiron t'i refuzojë nga shoqëria. Pastaj Sekretarët gjeneralë të kontinenteve kanë paraqitur

programet dhe kanë prezantuar relacionet e tyre. Kontinenti afrikan, djepi i karizmave dhe thirrja më e afërt për jetën misionare, vazhdon të ketë karakterin e ungjillëzimit dhe kishës misionare. Ky kontinent thërret më shumë këtë institut, sepse është duke e kondicionuar mentaliteti modern dhe është dalëngadalë duke e penguar programin misionar të kombonianëve, por të vetëdijsohem edhe për rreziqet që i kanosen misionarëve, ka thënë ndër të tjera eprori gjeneral dhe kanë marrë masa për të ndërkombëtarizuar programin e tyre edhe në shoqata e organizata botërore. Edhe kontinenti i Azisë ka zgjuar interes meqenëse kanë thirrje misionare sidomos nga Filipinet, Makao dhe Taiwan. Evropa është shterur me thirrje për shkak politikave liberale dhe antikishtare që kanë ushtruar shtetet dhe që ushtrojnë ende nëpër shkolla dhe universitete, jo me fenë si helm, por si të panevojshme.

VATIKAN – Janë nominuar kardinalët, ipeshkvinjtë dhe ekspertët për Asamblenë e dytë Gjenerale të Sinodit Ipeshkvor Afrikan

Shenjtji Atë Papë Benedikti XVI ka nominuar pjesëtarët për Asamblenë speciale të dytë për Kishën Afrikane të Sinodit Ipeshkvor që do të mbahet nga data 4 deri më 25 tetor në Vatikan. Të nominuar nga Papa për këtë sinod të rëndësishëm për kontinentin afrikan janë: kardinalët Angelo Sodano, Pëter Erdő, e André Vingt-Trois; Arqipeshkvi Robert Sarah, Sekretari i Kongregatës për Ungjillëzimin e Popujve, Henri Teissier, Jaime Pedro Gonçalves, Orlando B. Quevedo, Luigi Bressan, Raymond Damasceno Assis, Henryk Hosier, Ipeshkvinjtë John Anthony Rawsthorne, Peter



William Ingham, Jean-Pierre Bassène, Giorgio Bertin; mesh-tarët Raymond Bernard Goudjo e Juvenalis Baitu Rwelamira, At Emmanuel Typamm. Dhe Sekretari gjeneral i Sinodit Ipeshkvor, dhe me aprovimin e Papës ka nominuar dëgjues dhe ekspertë të tjerët si ndihmesë për këtë sinod.

Papa në Republikën Çeke për një Evropë të bashkuar shpirtërisht

Udhëtimi apostolik i Papës Benedikti XVI në Republikën Çeke

Nga data 26 deri më 28 shtator, Ati i Shenjtë do të vizitojë Pragën, Brnon e Stara Boleslavin, ku është martirizuar Pajtori i kombit, shën Vençeslau. Praga është një nga qytetet më të bukura të botës: shtrihet mbi shtatë kodra dhe përshkohet nga lumi gjarpëruës Moldava, ujërat e të cilit flasin për një të kaluar të lavdishme e për një fe të përkthyer në art në stilin romanik, gotik dhe barok. Perlë e vogël e Evropës! Në këto troje, mese njëmijë vjet më parë, filluan misionin e tyre vëllezërit Çirili e Metodi, të cilët ndërtuan urat e para ndërmjet botës hebraiko-greko-latine dhe asaj sllave, duke shpikur alfabetin përmes të cilit këto popullsi mundën të lexonin Ungjillin në gjuhën e tyre. Por dy vëllezërit nuk e patën të lehtë. Po ashtu, edhe ata që i imituan.

Çekia është tokë martirësh: Shën Vençeslau u vra, sepse me Ungjillin vinte në dyshim interesat e të pushtetshmëve; Shën Ludmillës, nënës së Vençeslaui i futën duart në fyt, vetëm sepse jepte këshilla "të krishtera"; Shën Adalbertin e qëlluan me shtizë pasi kishte shpallur se Jezusi është Zoti i mishëruar; Shën Gjon Nepomuçeni u la të mbytej në lumin Moldavë, sepse nuk dëshoi t'i thoshte mbretit sekretet që njerëzit ia kishin besuar në Krëfëstare; Shën Gjon Sarkanderi u torturua e u vra, pasi gjatë luftërave fetare nuk mbante anën e askujt, por donte vetëm të ishte në paqe me Zotin. Tokë dhimbjesh dhe ringjalljeje: në Brno, në burgun fortesë të Spilbergut, patrioti italian Silvio Peliko, pas tetë vjet vuajtjesh, ri-gjeti fenë dhe i fali salvuesat, duke shkruar "Burgjet e mia",


traktati i parë mbi të drejtat e të burgosurve. Tokë e dhunuar nga dy diktatura: ajo naziste e ajo komuniste, të cilat patën pretendimin e rremë të ndërtonin një botë kundër Zotit e pa Zotin. 20 vjet më parë binte regjimi fillosofjik, që mendonte se do t'i zgjidhte shqetësimet e njeriut vetëm në planin ekonomik e material. E pikërisht 20 vjet më parë, Papa Gjon Pali II kanonizonte shën Anjezën, princeshë boheme, që në shekullin XIII u shpërndau të varfërve gjithëkja kishte për të ndjekur Krishtin në kryq. Ndoshta diçka më pak e logjikshme, por shumë më tepër bindëse.

Shqetësimet e njerëzimit janë përshkruar më së miri nga një shkrimtar i madh, që ka lindur në Pragë, nga Franc Kafka (1883 – 1924). Në veprat e tij (Meta-morfoza, Procesi, Kështjella) njeriu sundohet nga një faj i mistershëm, që duhet të lajë pa e ditur pse. Një e keqe pa fund, që e shtyp jetën në ditë pa kuptim. Papa Gjon Pali II, në tri udhëtimet e tij në këtë vend, shpallti të Vërtetën që çliron nga kjo peshe e padurueshme e nga dhuna që vjen prej saj, shpalli mëshirën e Zotit, e cila duhet ndjekur nga falja e njeriut. E kështu, kërkoi falje dhe ofroi falje: për vuajtjet e shkaktuara, si në rastin e Jan Husit, reformatorit bohëm të djegur në vitin 1415, e për vuajtjet e pësura. Falja e Zotit i përket një logjike tjetër, ka tjetër gramatikë dhe ngjall mendime e veprimet krejtësisht të reja. E sidomos ka kohën e vet të mistershme për

të prodhuar fryte, që njerëzimi i pavëmendshëm, me shpejtësinë me të cilën ecën, as që i vëren. Benedikti XVI shkoi në Republikën Çeke në gjurmët e Gjon Palit II, duke bërë thirrje për të mos pasur frikë, për të mos dyshuar, për t'u nisur nga feja: koha është e Zotit. Mullinjtë e Zotit – thotë një fjalë e urtë çeke – bluajnë me avash, por e bëjnë shëlgun dash.

Një nga personalitetet më në zë të Kishës çeke është kardinali Tomash Shpidlik, lindur 90 vjet më parë në Brno të Moravisë. Jezuit, i dënuar me punë të detyruar më parë nga nazistët e më pas nga komunistët, u bë meshtar në moshën 30 vjeç, në mesin e vështirësive. I njohur për studimet e librat mbi përshpirtërinë e Kishave të Lindjes, jeton e punon në Qendrën Alet të Romës. Papa Gjon Pali II e krijoi kardinal në vitin 2003. Pikërisht ai e thotë një mendim për këtë vizitë të Benediktit XVI: "Gjon Pali II erdhi këtu 20 vjet më parë, kur muri i Berlinit e me të edhe komunizmi, që ia la vendin Evropës së re. Gjon Pali II pohoi se qëllimi i vizitës së tij ishte të pu-

nonte për bashkimin shpirtëror të Evropës. Benedikti XVI vjen 20 vjet më pas e vjen pikërisht në Pragë, që është qendra gjeografike e Evropës. Kjo vizitë e re e Papës na bën të mendojmë: duhet ta bashkojmë Evropën shpirtërisht. Udhëtimi i Papës nuk është politik, por shpirtëror. Çekët janë popull me origjinë lindore, që kanë jetuar 2000 vjet më parë në qytetërimin e kulturën perëndimore. Kështu, ata mund t'i pajtojnë këto dy mentalitete, që Evropa, e cila për shumë kohë ka qenë e ndarë më dysh, të rikthehet në një Evropë të vetme".



Kinë – 60-vjetori i Republikës Popullore të Kinës

"Lirojini ipeshkvijtë, meshtarët, murgeshat dhe besimtarët katolikë nga burgu!"

Këtë e kërkon kardinali Zen Li Hong Kongut, i cili duke i vlerësuar fjalët e kryetarit të Kinës që ka deklaruar të promovojë demokracinë dhe solidaritetin dhe të ndërmarrë kontakte me Selinë Apostolike. Në një porosi të kardinalit Zen thuhet ndër të tjera: "Në 60-vjetorin e themelimit të Republikës Popullore të Kinës, është momenti që dirigjentët e lartë shtetërorë të marrin guximin për t'i korrigjuar gabimet e së kaluarës, duke i liruar të burgosurit fetarë, sidomos Ipeshkvijtë". Këto fjalë i thotë duke u nisur nga një deklaratë e kryetarit Hu Jintao që kanë zgjuar te kardinali "një fije shprese", sepse kryetari i shtetit duke folur përpara Komitetit kombëtar të konferencave politike konsultative të popullit kinez (National Committee of the Chinese People's Political Consultative Conference CPPCC) në datën e 20 shtatorit Hu Jintao ka thënë ndër të tjera se funksioni i këtij organizmi është për të: "të promovojë demokracinë, të forcojë solidaritetin, të koordinojë raportet dhe t'i zgjidhë kontraktat". Kryetari ka shtuar edhe se CPPCC ka për detyrë të "angazhohet të promovojë ... zhvillimet harmonike në raportet religjioze, ...me popullin brenda shtetit dhe me shtetet tjera".

Kjo ofrohet si një sfidë dhe



një rast i veçantë për popullin dhe politikën kineze. Por, mbi të gjitha, duhet të bëhet e qartë kombëtarizimi në raport me fenë dhe me udhëheqjen e Kishës. Sepse feja nuk është kundër dhe opozitë e patriotizmit dhe dashurisë ndaj atdheut.

Në këtë 60-vjetor Kina do t'i dëshmojë botës mbarë fuqinë ushtarake që më i tetor do të paraqiten në qendër të Pekinit afër 8.000 ushtarë me armët më moderne, "made in China", që do të dalin për të parën herë në publik për të dëshmuar arrijtet teknologjike dhe bërthamore. Një shtet që kërkon supremacinë ushtarake, edhe pse miliona njerëz janë në varfërinë më të skajshme.

Kjo paradë ushtarake dëshiron të dëshmojë edhe agresivitetin e aparatit shtetëror komunist. Gjeneralët ushtarakë kanë dëshmuar se një paradë e tillë e dëshmon "ushtrinë më të fortë botërore, e cila kujdeset për ruajtjen e lirisë së popullit kinez dhe integritetin territorial". Kjo paradë ushtara-



ke do të ketë në dispozicion 14 formacione të ndryshme ushtarake me prezantimin e armatimit të tyre, ku do të ketë edhe armë balistike interkontinentale, tanke të fushëbetejave dhe armë të tjera nga më të ndryshmet me 150 aeroplanë, helikopterë, të cilat e dëshmojnë se njeriu është

armik i vetvetes. Kjo dëshmon se ky shtet është i aparatit ushtarak dhe e mban shtetin nën udhëheqje të dhunshme dhe me presion. Sfilata do të zgjasë 100 minuta në sheshin Tiananmen, ku në përfundim do të jetë një spektakël i fishekzjarrëve.

Statistika e Kishës Katolike në Republikën Popullore Kineze – Katolikë: 12 milionë

Dioqeza: 138

Ipeshkvij: 120
(mosha mesatare: 74)
Jozrtarisht: 46
Zyrtarisht: 74

Meshtarë: 2740
Jozrtarisht: 1000
Zyrtarisht: 1740

Murgesha: 5200
Jozrtarisht: 1700
Zyrtarisht: 3500

Seminaristë: 1380
Jo zyrtarisht: 800
Zyrtarisht: 580

Novice: 1600
Jozrtarisht: 800
Zyrtarisht: 800

* Zyrtarisht: janë ata të njohur nga shteti dhe që shteti ka ndikim në zgjedhjen e tyre.

* Jozrtarisht: janë ata që zgjidhen nga Selia e Shenjte dhe që nuk janë dakord me ashtuqajturën Kishën Patriotike.

Përgatitjet për një takim të mundshëm mes Papës Benedikt XVI dhe Patrikut Kiril të Kishës Ortodokse Ruse

Kisha Katolike dhe ajo Ortodokse kanë dalë me deklaratat të përbashkëta duke i ripohuar vlerat e përbashkëta të krishterave në botën e sotme, tani do të sjellin edhe një intervistë të shkurtër të Ipeshkvit Ortodoks i cili u takua me Papën Benedikt XVI.

Nuk ka mbaruar dialogu mes Kishës Katolike dhe Ortodokse. Arqipeshkvi Hilarion, ministri i ri i punëve të jashtme të Patriarkekanës Ruse, e ka takuar Papën në Castel Gandolfo. Një hap i rëndësishëm për dy kishat të ndara me më shumë se 1000 vjet.

"Kisha katolike dhe ajo ortodokse nuk duhet të jenë konkurrenca njëra ndaj tjetrës por aleatë për t'i dëshmuar vlerat e përbashkëta përpara sfidave të kohës sonë" kjo është thirrja që i bënë Ipeshkvi ortodoks që ka dashur të nënvizojë edhe respektin që e ka Patriarku i Moskës ndaj Papës Benedikt XVI të cilët njiheshin edhe para se t'i merrnin detyrat e udhëheqjeve kishare. Ndër të tjera ka thënë: "Ne e mbështesim Papën në detyrat dhe në mbrojtjen e vlerave të krishterave, e mbështesim edhe



atëherë kur merr kurajën të dalë me deklaratat për të reaguar ndaj politikave negative ndaj disa politikave që e gënjëjnë botën nëpërmjet masmediave. Besojmë se e ka detyrë të dëshmojë të vërtetën dhe jemi pra me Papën dhe jo opozitë e deklaratave të tij". Ipeshkvi ka deklaruar edhe për një takim të mundshëm ndaj Patrikut Rus dhe Papës. "Personalisht shpresoj një takim të tillë që të realizohet sa më shpejt.

Mund të them me përgjegjësi se nga të dyja anët është kjo dëshirë e kamotshme për të përgatitur një takim me shumë kujdes për temat që duhet trajtuar".

Një takim i tillë do të bënte një hap gjigant në sferën e ekumenizmit ndaj dy kishave. Sepse krizat në cilat jeton bota, është duke i pësuar edhe kisha katolike dhe ajo ortodokse, si për shembull, hedonizmin, relativizmin, shekullarizmin, konsumimin e shfrenuar, refuzimi i vlerave të krishterave.

"Ndaj këtyre sfidave ne të krishterët në veçanti ortodoksët dhe katolikët duhet t'i përgjigjemi së bashku. Së bashku mundemi t'u propozojmë politikave, shoqërive vlera shpirtërore dhe morale. Së bashku mundemi t'u ofrojmë vizionin tonë të krishterë mbi familjen dhe të paraqesim drejtësinë sociale, pastaj mbi ekologjinë, mbrojtjen e jetës".

Kisha nuk është "një supermarket i shpirtërave" ka thënë Ipeshkvi Hilarion, por Kisha "e bën jetën më njerëzore dhe hyjnore".

21 Shtatori: Dita e Paqes Ndërkombëtare

Dita e paqes është caktuar zyrtarisht nga Asambleja e Përgjithshme e OKB në vitin 1981, me Rezolucionin A/RES/36/67, me qëllim të forcës vullnetin e paqes ndërmjet kombeve dhe shteteve. Nga viti 2001 celebrimi i kësaj dite është futur me ditë 21 shtator të çdo viti, nëpërmjet Rezolucionit A/RES/55/282, dhe është caktuar që në këtë ditë të ndalet çdo lloj lufte, kjo është dëshmuar edhe në Afganistan që forcat e koalicionit USA-NATO kanë suspenduar në këtë ditë luftën kundër talebanëve duke u dërguar porosi paqeje. Kjo Rezolutë i thërret të gjitha shtetet pjesëtare të kësaj Organizate, të gjitha kombet, dhe çdo individ në mënyrë personale të kontribuojnë për këtë ditë nëpërmjet edukimit, vetëdijesimit dhe ndarjes se vlerave për paqe dhe bashkëpunimit aktiv në gjitha nivelet dhe sferat e jetës sociale.

60-vjetori i krenimit të dal-



jes se Deklaratës për të Drejtat Universale të Njeriut e festuar vitin e kaluar, e ka nënvizuar faktin se edhe sot me intensitet me të madh i jep vlefshmëri paqes dhe drejtës njerëzore, përcaktimit dhe respektit duke e ruajtur sidomos dinjitetin e personit si e drejtë themelore e çdo të drejte. Paqja është e njohur si një e drejtë që i takon çdo populli nëpërmjet Deklaratës mbi të Drejtën e Popujve të viti 1984, e aprovuar nga Rezoluta 39/11.

Edhe Papa Benedikt XVI ka bërë thirrje tërë botes për Paqe sepse Kisha është e vetmi që i paqes, solidaritetit, njohjes së të vërtetës, që e thërret njeriun të jetë njeri në mesin e shoqërisë; Papa sidomos ka bërë thirrje të luftojmë varfërinë e të ndërtojmë paqen e vërtetë, e kjo porosi e paqes i bashkëngjitet edhe 6 ushtarëve italian që u vranë nga një bombë kamikaz në Afganistan.

(Përgatit don Pal Tunaj)

Gjoni, biri i Zebedeut

■ PËRGATITI:
Don Marjan MARKU

Në takimin e sotshëm dëshirojmë edhe më tutje të takohemi me një person shumë të rëndësishëm të kolegjit apostolik, me Gjonin të birin e Zebedeut dhe vëllanë e

Jakobit. Emri i tij i përkthyer nga hebraishtja domethënë: »Zoti ka dhuruar hirin«. Ai ishte duke i paluar rrjetat në breg të liqenit të Tiberiades, kur e thirr Jezusi së bashku me vëllanë e tij (krah. Mt 4,21; Mk 1,19). Gjoni ishte njëri prej grupit të ngushtë të Jezusit, të cilin për raste të rëndësishme e merrte me vete. Ai ishte së bashku me

Pjetrin dhe Jakobin, kur Jezusi hyri në shtëpinë e Pjetrit në Kafarnaum për ta shëruar vjehrrën e tij (krah. Mk 1,29); po ashtu ishte së bashku me të dy edhe në shtëpinë e Jairit, kryetarit të sinagogës të cilit ia ngjalli vajzën (krah. Mk 5,37); ai shkoi pas Jezusit, kur u ngjiti në mal për tu shndërruar (krah. Mk 9,2); ai

ishte po ashtu në anën e Jezusit në malin e ullinjve, i cili duke e shikuar tempullin e Jerusalemit foli për përfundimin e qytetit dhe të botës (krah. Mk 13,3); dhe përfundimisht ishte afër tij, kur

Jezusi u tërhoq në kopshtin e Gjetsemanit për t'iu lutur Atit para mundimit të tij (krah. Mk 14,33). Para festës së Pashkëve, kur Jezusi i caktoi dy nxënësit për ta përgatitur sallën për ngrënien e darkës së fundit, këtë detyrë ia besoi Gjonit dhe Pjetrit (krah. Lk 22,8).

Ky qëndrim i jashtëzakonshëm i Gjonit në mesin e 12 apostujve, e tregon iniciativën e tij të kuptueshme në pyetjen e nënës së tij, e cila erdhi tek Jezusi për t'iu lutur për dy djemtë e saj, Gjonin dhe Jakobin, që të ulen në mbretërinë e tij njëri në të djathtën e tjetri në të majtën (krah. Mt 20,20-21). Siç e dimë, përgjigjja e Jezusit ishte me kundërpjetje: a kishin për të qenë të gatshëm për ta pirë kelkun, të cilin ai do ta pijë (krah. Mt 20,22). Me këto fjalë vazhdon shpjegimi për t'iu hapur sytë

nxënësve për ta kuptuar fshehtësinë e personit të Jezus Krishtit dhe për ta kuptuar domethënien e thirrjes së tyre të ardhshme, për të qenë të gatshëm për t'iu dorëzuar deri në vdekje.

Pak më vonë Jezusi precizoi, që ai nuk ka ardhur për të qenë i shërbyer, por për të shërbyer dhe për ta dhënë jetën për shpërbimin e shumë njerëzve (krah. Mt 20,28).

Pas ngjalljes së Jezusit përsëri i takojmë së bashku të bijtë e Zebedeut me Pjetrin dhe me disa nxënës tjerë të cilët tërë natën kishin tentuar për të zënë peshk, por pa sukses dhe me iniciativën e të ngjallurit në mënyrë të mrekullueshme kishin zënë shumë peshk: »Nxënësi të cilin Jezusi e donte«, ishte i pari i cili njohu Zotin dhe i tregoi Pjetrit (krah. Gjn 21,1-13).

Në Kishën e Jerusalemit Gjonin kishte një rol të jashtëzakonshëm në udhëheqjen e grupit të parë të të krishterëve. Pali e numëron si shtyllë të bashkësisë (krah. Gal 2,9).

Luka në veprat e apostujve

“Gjykoni ju vetë a është e drejtë para Hyjit: të dëgjojmë më parë ju se Hyjin? Ne, veç, nuk mundemi që të mos flasim për çka kemi parë e dëgjuar!” (Vap 4,19-20).

lajmëron për shkuarjen e tij në tempull së bashku me Pjetrin për tu lutur (Krah. Vap 3,1-4,11) apo si u paraqit para këshillit të lartë për të dëshmuar besimin në Jezu Krishtin (krah. Vap 4,13,19). Së bashku me Pjetrin ishte i dërguar prej Kishës në Jerusalemin për të forcur ata në fe të cilët kishin pranuar ungjillin në Samari dhe për tu lutur dhe për ta pranuar Shpirtin Shenjt (krah. Vap 8,14-15). Në mënyrë të posaçme duhet përmendur dëshminë e tyre, të Pjetrit dhe Gjonit para këshillit të lartë: »Ne, veç, nuk mundemi që të mos flasim për çka kemi parë e dëgjuar!» (Vap 4,20). Ky guxim në dëshminë e fesë duhet të jetë edhe për ne një dëshmi dhe vendosje për të dëshmuar dhe për të predikuar me besnikëri fenë e Jezu Krishtit.

Sipas traditës Gjoni, nxënësi i dashur në Ungjillin e katërt në darkën e fundit kishte mbështetur kokën e tij në parzmën e Jezusit për ta pyetur kush është tradhtari (krah. Gjn 13,25) dhe së bashku me Marinë nënën e Jezusit qëndroi pranë kryqit (krah. Gjn 19,26). Përfundimisht është dëshmitar i varrit të zbrazët dhe i ngjalljes së Jezusit (krah. Gjn 20,2; 21,7). Ne e dimë se identifikimi në mesin e shkencëtarëve është i dyshimshëm prej të cilëve Gjonin e shohin si prototip të nxënësit të Jezusit.

Kjo detyrë është punë e egzakte për ta sqaruar, por për ne është e rëndësishme që nga Gjoni dhe nga jeta e tij të mësojmë për jetën tonë. Zoti dëshiron që secilin prej nesh ta bënë një nxënës të tij, dëshiron të jeton me ne në miqësi. Dhe për ta realizuar këtë, nuk mjafton vetëm të shkojmë pas tij dhe ta dëgjojmë fjalën e tij, por të jetojmë me të dhe të jetojmë si ai. Kjo mund të realizohet vetëm në lidhshmëri dhe besim të afërt me të. Kjo është ajo çka ndodh në mes miqve dhe

për këtë arsye Jezusi tha një herë: »Dashuria më e madhe që ndokush mund të tregojë është të jap jetën e vet për miqtë e vet... Nuk ju thërras më shërbëtorë, sepse shërbëtorin nuk di çka bën zotëria i tij; unë ju quajta miq, sepse ju zbulova gjithçka që dëgjova prej Atit tim« (Gjn 15,13,15).

Në apokrifet e akteve të Gjonit, ky apostull shihet si themelues i bashkësisë dhe në udhëheqje të bashkësive të krijuara, por si një shtegtar dhe lajmëtar i fesë në takime me shpirta të cilët janë të aftë për shpresën e shëlbimit (18,10; 23,8).

Gjithçka e ka kuptimin e vet në aspektin paradoks, nga e pamundura të bëhet e mundshme. Dhe nga veprat e tij Kisha Lindore e quan »Teolog«, pra ai i cili është në gjendje të flas për gjërat Hyjnore me fjalë të kuptueshme dhe kështu përmes lidhshmërisë me Jezusin të mundësoi në mënyrë të fshehtë takimin me Hyjin.

Adhurimi i Gjonit apostull ka filluar nga qyteti i Efëzit i cili sipas traditës antike ka qëndruar një kohë të gjatë në këtë qytet dhe në një moshë mjaftë të shtyrë në kohën e mbretit Trajan ka vdekur. Në Efëz në shekullin e 6, mbreti Justinian në nder dhe lavd të tij kishte ndërtuar një bazilikë të madhe, ku mund të shihen edhe sot gërmadhat e kësaj bazilike. Në Kishën e Lindjes e nderojnë shumë. Në ikonografi në bizantine tregohet si një njeri i vjetër sipas traditës i cili ka vdekur në kohën e mbretit

Trajan në qëndrim të thellë kontemplativ.

Të lusim që të na ndihmoi Zoti që të shkojmë në shkollën e Gjonit dhe që ta mësojmë leksion të madh të dashurisë dhe që ta ndiejmë vetën se jemi të dashur prej Krishtit deri në fund (Gjn 13,1) dhe që ta jetojmë jetën tonë për të.



Familja dhe kurora e martesës – përcaktim hyjnor

■ PËRGATITI:
Marjan Sebah - SOPI

Mëkati – problem i vërtetë i martesës Shenjte!

Derisa mendojmë mbi këtë gjë, pyesim e çka është në të vërtetë problem në martesë? Shkurt, problem është mëkati. Mëkati i cili vepron në njeriun, vërtet vepron edhe në martesë. Njeriu me mëkat largohet nga Zoti, bëhet rrugaq, endacak në këtë jetë. Njeriu zgjodhi rrugën e vet personale, pikërisht kur i tha Zotit "JO" kurse djallit "PO", atëherë pau se nuk u bë si Zoti, por u bë i kufizuar, i mjerë, qenie "lakurice". Çdo mëkat çnjerëzon njeriun, çdo mëkat njeriun e bën më pak njeri. Mëkati ka gjithmonë dy anë. Në njerën anë tregon kur na ngashnjen në diçka, kurse në anën e dytë e tregon kur të zhytesh. Të kemi kujdes, sepse djalli është i veshur gjithmonë në petka, robra solemne e vizëlluese, për këtë gjë ruaj, sepse mëkati, e keqja, gjithmonë do të të ngashënjëjë më shumë se Krishti i rrahur, i përgjakur e i zhveshur. Mjerisht pak janë ata të cilët i përfiton dhe mahnit kjo pamje e mjerë e Jezu Krishtit! Mëkati është i pëshqjellët në rrobe të bukura, në ngjyra të bukura e të llojllojshme, kurse ne nuk shohim njerimin, i cili fshihet pas tij! Shohim e vetëdisohemi qysh atëherë kur lejojmë të zotërojmë në ne mëkati! Pra, kur sot në shekullin e njëzet e një pyesim çka është shkaktari i shkatërrimit të martesës, atëherë përgjigja është: mëkati i cili vepron në njeriun! Sepse, me mëkat njeriu më nuk është ai integral i tillë siç ishte dhe siç është paraparë të jetë. Mëkati, pra rrënoi martesën. Nëse i shikoni sot njerëzit në martesë, ata të cilët janë varrosur me mëkat, do të shihni e vëreni se shpesh janë dy anë, pjesë vetjake, egoiste ku secili tendon të ngrehë kah ana e vet e të cilët shumë rrallë e me vështirësi flijohen njëri për tjetrin! Ata shpesh pendohen, por mjerisht ndalen! Ka edhe të tillë që pandërpre lundrojnë aty – këtu e prapë mbesin askund, por tërë jetën në mëkat! Pse ndodh kjo? Pikërisht, shkaku se njeriu më "nuk ka kohë të ndalet e të mendojë" nuk është i vetëdijshëm mëkatin, e vet "nuk ka kohë" të shkojë e rrëfëhet, të bisedojë e të kshillohet me meshtarin, rregulltarët e rregulltarët!

Kështu që sot, ka edhe të tillë që pyesin se a është aborti mëkat!!! A janë mëkat prezervativët e ndryshëm etj!!! Të gjitha i bëjnë duke i ngashnjyer djalli, kurse turpërohen të pyesin e të kshillohen me meshtarin, bariun e babën e tyre shpirtëror, i cili pret t'i ndihmojë çdokujt, sepse për atë u përgadit tërë jetën e në shërbim të tyre flijoi e po flijon vetvetën! Mos ngurro, mos rri në mëkat! Pra, me kujdes e nderim shikoni e pranoi këshillat e ndihmën... në bashkëpunim me meshtarin analizo, kuptoje si ka qenë në fillim gjithë ideja, kuptimi e përcaktimi hyjnor. Problem pra është vetë natyra jote, e cila është e plagosur (varrosur) me mëkat, natyra e cila është e nënshtruar egoizmit, egocentrizmit etj... Nëse dëshiron të kesh një martesë, një familje të shenjtë e shembëll, një jetë pa probleme, të lumtur e të hareshme në dashuri

me Zotin e të afërmin, RUAJU
NGA MËKATI - DJALLI!

Martesa (kurora) nuk u krye askurrë – ajo është ndërtim-tari!

Dhe, më në fund, një gabim i madh kur bëhet fjalë për martesë. Ky gabim është kur mendohet se martesa është diç e përfunduar, e kryer, gati e në të cilën hytë "sikur kur t'i marrësh çelësat e banesës" dhe ja, mendohet se je në te – në martesë! Martesën shpesh mund ta analizojmë dhe paraqesim sikur një vend, plac ndërtimor. Ja, pra aty do të ndërtoni shtëpinë, vatrën tuaj! Juve ju dhurohet vendndërtimi e kjo është dita e shenjtë e martesës kishtare. Pastaj ngjan kjo: unë e vë një gur, pastaj ti një tjetër, unë dy gur e ti tre dhe kështu me radhë. Mirëpo, ke të tillë që njëri e vë një gur e vjen tjetri dhe e heq dhe kështu rrënohet martesa! Nëse pra nda-

lesh të punosh rreth ndërtimit të shtëpisë e rri vetëm duke shikuar shtëpinë, ajo nuk do të kryhet kurrë, kurse shumë shtëpi tjera të filluara do të përgaditen për ta qitur pikën (mbulojnë). Zoti, duke na njohur që nga fillimi, na ka ftuar e na fton në ndërtimin e shtëpisë, Ai na ka treguar se si duhet ndërtuar atë shtëpi, ka edhe planin. Njeriu së fundi edhe vetë e sheh se nuk shkon duke thënë: ka hy një djall e nuk po më le. Vazhdon: të gjithat i kam, kam dëshirën, vendosi dhe kur më duhet – nuk shkon!

Pra, martesa nuk është një send apo punë e kryer. Ky mendim është mashtrim. Martesa është një lloj ndërtimtarie. Materiali ekziston aty, pra t'ia fillojmë punën. Duhet të vetdijsohemi e veçanërisht t'i përkujtojmë të rinjtë, cilët përgatiten për martesë se problemi numër një është pikërisht atëherë kur burri dhe

grauja mendojnë se vetëm me hyrje në martesë ka përfunduar gjithçka dhe se fillon gëzimi, paqja e hareja...Jo, jo me këtë nuk është krye asgjë! Por, të dy jeni aty dhe aq sa ndërtoni së bashku aq edhe do të keni. Ajo çka është e të cilën e përcaktoi Hyji, atë ne po e njohim, por njëkohësisht jemi edhe të ftuar që këtë ta realizojmë.

Njeriu është qenie dashurie!

Në Bibël lexojmë se Shën Gjoni ungjilltar Hyjin e ka definuar si dashuri. "Hyji është dashuri". Ekzistojnë definicione të ndryshme mbi Hyjin. Po, edhe para Gjonit shumë filozofë e dijetarë kanë tentuar ta definojnë Hyjin. Për shembull, Platoni ka thënë se Hyji është bukuria dhe mirësia. Aristoteli thoshte se Hyji është lëviztari i palëvizshëm. Po ashtu edhe teologët kanë dhënë definicione të ndryshme mbi Hyjin, psh. Hyji është qenie e përsosur, pastaj plotësim i ekzistencës etj... Mirëpo, Gjoni tha: "Hyji është dashuri". Kjo është shumë me rëndësi – po që se dëshirojmë ta kuptojmë njeriun – sepse njeriun nuk mund ta kuptojmë pa Hyjin. Ishte një gabim e mashtrim i madh, kur është tentuar të kuptohet njeriu pa Hyjin – ateizmi.

Njeriu pa Hyjin nuk është në gjendje të kuptojë, të dijë nga është, prej nga ka ardhë, për ç'arsy është dhe ku shkon. E njeriu është prej Hyjit dhe këtë e dimë prej atij mëngjesi krijues. Hyji e caktoi e krijoi njeriun në përgjasimin e qenies së vet personale. Hyji tha: "Ta bëjmë njeriun në përgjasimin tonë". Dhe mu për këtë mund ta themi definicionin se Njeriu është "qenie dashurie". Njeriu, pra është i krijuar prej dashurisë, për dashuri dhe jetën e vet mund ta realizojë vetën nëse jeton në dashuri, pammarsisht se a jeton në martesë apo jetë të kushtuar Hyjit (jetë rregulltare). Pa dashuri, njeriu nuk ka mundësi të jetojë, ai vdes. Paramendojeni njeriun, i cili në vetë nuk ka asnjë gram dashurie, i cili nuk është i rrethuar me dashuri, e po të mos ketë asnjë hije dashurie, kuptohet se çka do të ndodhë me të, ai nuk do të kishte jetë, pra do të vdiste. Do të vdiste apo do të bënte vetvrasje. Sepse ky është ligj themelor njerëzor – Njeriu është krijuar nga dashuria, për dashuri u krijua dhe është i ftuar të dojë – pikërisht për këtë edhe Shën Gjoni thotë: "Të dashur, duani njëri – tjetrin sep-



“ Njeriu pa Hyjin nuk është në gjendje të kuptojë, të dijë nga është, prej nga ka ardhë, për ç'arsy është dhe ku shkon. E njeriu është prej Hyjit dhe këtë e dimë prej atij mëngjesi krijues.

“ Ndoshta sot nuk ka asnjë fjalë më të devaluuar se fjala dashuri. Mirëpo, çka është ajo ku rinia gabon apo pështjellon dy dukuri, fenomene apo situata: dashurimin dhe dashurinë! Këto janë dy dukuri të ndryshme njëra ndaj tjetrës. Janë dy të vërteta krejtësisht të dalluara e të ndryshme mes veti. ”

se dashuria është plotësim”. Në veçanti me rëndësi është kjo, kur atëherë mendojmë mbi specifitetin në cilin gjindet e kjo është se Hyji e krijoi njeriun, Maskull e femër. Duke e shikuar dinamiken e kësaj marrëdhënieje të ndërsjellët, lirisht mund të themi se këta të dy mund të gjejnë kuptimin e vet të vërtetë dhe bashkëjetesën e tyre e që kjo të arrijë të plotësimi pikërisht vetëm atëherë nëse mes tyre e në ta qëndron DASHURIA, këtë e arrijmë kur jemi të vetdijshëm se jemi të krijuar në përgjasimin e Hyjit si Njeri. Sepse maskull e femër janë Njeri. Nëse, pra njeriu është i krijuar për mirëmbajtjen e qenies hyjnore, atëherë së pari jemi të ftuar që ta mirëmbajmë dashurinë. Bashkësia do të ketë kuptim vetëm atëherë nëse në të jeton e mbretëron DASHURIA!

Bashkëjetesa pa dashuri është ferr. Mesiguri se ndoshta keni përvojë ku njihni ndonjë çift matorës pa dashuri, ku është shuar e asgjësuar dashuria. Aty e dini se u krijua ferri. Aty e dini se jeta është e pamundshme. Kështu, pra në martesë mund ta takoni fytërin hyjnore, por edhe atë të ferrit të vërtetë. Jetoni me Zotin dashuri, do të jeni të lumtur!

Dashuria dhe dashurimi

Thonë se fjala dashuri është një fjalë e madhe. Të gjithë flasin mbi dashurinë e rreth dashurisë. Të gjithë këndojnë mbi dashurinë! Sot sa ta hapni televizorin apo radion, menjëherë do të dëgjoni këngë për dashuri; dashuria ime ku je, eja... etj.

Ndoshta sot nuk ka asnjë fjalë më të devaluuar se fjala dashuri. Mirëpo, çka është ajo ku rinia gabon apo pështjellon dy dukuri, fenomene apo situata: dashurimin dhe dashurinë! Këto janë dy dukuri të ndryshme njëra ndaj tjetrës. Janë dy të vërteta krejtësisht të dalluara e të ndryshme mes veti. Jo vetëm se kanë dallim mes veti, por se martesat askurrë nuk kishin dashur me u lidhë nëse aty ekziston vetëm dashurimi. Martesa e tillë, e cila u lidh vetëm në sajë të dashurimit (se ka ekzistuar dashurimi) e ku nuk ka pasur dashuri, në këso martesë njerëzit në problemet e para që janë paraqitë, kanë ra në provim. Që të identifikojmë këto dy dukuri dhe këto dy të vërteta jetësore e që mund të na kush- tojnë shumë, kishitë qenë mirë t'i themi dy – tri fjalë mbi to!

Dashurimi!

Çka është dashurimi? Dashurimi mund të themi është një sindrom i caktuar emotiv. Do të thotë, pra përmbledhje e shumë shenjave, por të cilat bazohen në plane të emocioneve apo interesit. Në rend të parë këtu është emocioni. Në rend të dytë të dashurimi vjen ndonjë detaj i personit psh. Se është siç themi i tillë apo e tillë, se ka këso koke, apo këmbë, duar, buzë etj... Pra, gjithësesi në këtë rast ndonjë detaj mbetet anash. Në rend të tretë vjen edhe interesi psh. më pëlqen ai person se qëndron materialisht mirë, ka vizë etj... Dhe gjeja e fundit që ekziston te dashurimi është përjetimi IM! Psh. ajo si e përjetoj unë! Dhe që të dështoj e gjitha kjo, është e nevojshme vetëm një ndërrim i detajit (ajo çka të ka pëlqyer ty) tek personi e kështu do ta bartë uji gjithçkafën te ai person në të cilin je dashuruar, ku nuk kishte dashuri, por dashurim! Mjafton të zvogëlohen emocionet e njërherë duhet të zvogëlohen, sepse njeriu nuk mund të ketë gjithnjë tension emocioneve të mëdha. Kishte me qenë shumë rrezik nëse njerëzit e rinj lidhin martesë në bazë, themele vetëm të dashurimit. Po, dashurimi është vetëm një lojë e tyre dhe mes tyre, mirëpo ata në asnjë rast ende nuk e kanë atë thellësi, e cila quhet DASHURI!

Dashuria!

Dashuria, pra është krejt diçka tjetër. Dashuria, para së gjithash, e përfshin tërë personin. Kjo do të thotë se unë nuk e dua atë pse ka kokë apo sy etj. të bukur, por në dashuri unë e dua tërë personin pamvarsisht nga mungesat e tij. Ajo që është me rëndësi te dashuria, është pikërisht komunikimi i personave!

Nuk besoj se ka njeri që ka kënduar ndonjë himn në të bukur e më mirë në lidhje me dashurinë se Shën Pali, teologu më i madh i Kishës. Prandaj, që të kuptojmë drejt e mirë, që të jetojmë jetë të lumtur familjare e bashkëshortore, të lexojmë së bashku himnin e dashurisë.

Merre Biblën apo Besëlidhjen e Re dhe e shfletojmë... Gjeje letrën e shën Palit drejtuar Korintasve, unë jam duke pritur... Me siguri se e ke gjetë... Pra, 1Kor.13,1-13. Fillojmë... analizo, kuptoje e pranoje dashurinë...

Ja, pra kjo është dashuria e cila nuk mbaron askurrë!

Familja dhe edukimi i fëmijëve

Çdo prindër dëshiron edukimin e mirë të fëmijëve, kështu që ata më vonë të jenë të mirë, të sigurt dhe të lumtur në jetë. Mirëpo kjo fatkeqësisht nuk ndodh. Përse?

Ka shumë shkaqe dhe arsye. Unë do t'i numëroj vetëm disa:

Së pari plotësimi i të gjitha dëshirave të fëmijëve, aq sa fëmija sot është bërë pothuaj "diktator" për familje, kërkon dhe

1. KRIJIMI I PERSONALITETIT DHE IDENTITETIT

Pa njeri s'ka as familje as shoqëri. Edukimi familjar është baza e çdo edukimi të mëvonshëm, sepse në familje formohet personaliteti bazor dhe identiteti personal. Çka domethën personaliteti bazor?

Pranimi i prinërve, vëllezërve,

fëmijëve ta realizojnë veten me pretendime: biri apo bija ime do të bëhet..., do të jetë..., do të fitojë...

Kjo mënyrë e ngarkon dhe rrënon fëmijën, sepse ia cakton një rol, një detyrë, një mision të pamundshëm, t'u përgjigjet nevojave dhe kërkesave, ëndërrimeve të prindërve. Fëmija gjendet gjithnjë në konflikt me veten, me prindër, me shoqëri, dhe së fundi rrezikon identitetin:



kushtëzohet çdo gjë dhe menjëherë, dhe prindërit duken të paafët, disi lëshojnë pe, dorëzohen para këtyre kërkesave, gabojnë rendë duke menduar dhe thenë: s'dua që fëmija im të vuaj si unë.

Mungesa e vlerave dhe virtyteve personale, familjare dhe shoqërore, si dhe mungesa e madhe e modeleve kulturore dhe shpirtërore dukshëm vështirson edukimin. Fëmijët s'duan dhe s'mund të jenë më si prindërit e tyre, sidomos për familje në rrethe të huaja, në diasporë, si dhe për prindër të varfër dhe të pashkolluar, të trajtuar si "primitive" dhe të prapambetur.

Prindërit s'janë gati aspak të përgatitur për rrethet të reja, për edukim të ri, të hapur, ku lypset kërkuar të mirën e përbashkët nëpërmjet bisedimeve, dialogut dhe komunikimit, por më tepër insistojnë në rregullore, në dishiplinë, në autoritet edhe të "grushtit" të dhunës.

Disorientimi edukativ, sepse tashtë askush nuk e di saktësisht dhe përfundimisht çka domethënë të jesh prindër, edukator, pasi ka ndryshuar botëkuptimi i jetës dhe i punës, tradita, kultura, ekonomia, politika, shkenca, arti, gati çdo gjë.

Globalizimi e ka përfshirë mbarë botën, por më tepër në dukuri negative, sidomos me anën e mjeteve pamoro-dëgjimore, duke ia imponuar njerëzimit materializmin, hedonizmin, indiferentizmin dhe ateizmin praktik, me pasoja tejet të rënda për jetën kulturore dhe shpirtërore.

motrave, rrethit familjar, si dhe pranimi i vetvetes në prizëm pozitive, me procesin e identifikimit me prindër, me procesin e socializimit – hapjes dhe bashkëpunimit, bashkëjetesës me të tjerët. Pa këto dy procese bazore s'ka as fëmijëri as rini.

Shprehja edukimi, edukata vjen nga latinishtja dhe ka dy veshtrime: *educare* – të ushqesh, *apo e-ducere* = të nxjerrësh jashtë, të udhëheqësh, të drejtosh kah. Prandaj ushqimi duhet të jetë i trefishtë: trupor, mendor/psikik dhe shpirtëror.

Të nxjerrësh jashtë, të drejtosh dhe të udhëheqësh dmth. se fëmija është qenie njerëzore, person, qysh nga ngjizja, lindja, prandaj duhet zbuluar në të mundësitë, aftësitë për ta nxjerrë nga bota e vogël, nga barku i nënës dhe i familjes, për t'u bërë vërtet njeri i matur dhe i pjekur, qytetar i botës /mondialiteti/.

Edukimi duhet të zbulojë aftësitë e fëmijës, ato duhet përkrahur dhe zhvilluar, duke nderuar natyrën, karakterin, talentet, moshën, gjininë... për ta ndihmuar dhe drejtuar kah vlerat dhe virtytet.

Familja duhet të edukojë sidomos:

Me PRANIMIN e gjithanshëm të fëmijës, ashtu si është, e jo ashtu si mendojmë dhe dëshirojmë ne, sepse ashtu e ngarkojmë apo projektojmë sipas dëshirave dhe nevojave tona. Prindërit të cilët nuk janë të kënaqur me vetveten, me palën martesore, mundohen nëpërmjet

kush jam unë, çka dua unë, dhe si dua unë të realizohem, si dhe personalitetin.

Çdo njeri së pari duhet të jetë vetvetja, pastaj mund të jetë edhe me të tjerët dhe për të tjerët.

T'i edukojmë fëmijët për jetë dmth. t'i AFTËSOJME për ballafaqime me të tjerët, jo për të sunduar mbi të tjerët, tendencat diktatoriale, apo për t'u nënshtruar të tjerëve, tendencat për servilizëm.

Edukimi i rreptë dhe me ndalesa, ndoshta edhe me ndeshkime, fëmijën e bën të pasigurt, prandaj e shtyn që të mbështetet në të tjerët, pa formimin e unit, ego-s, kështu që gjithnjë do të jetë i mvarur prej të tjerëve.

Çdo regull, ligj, normë pa motivim, mirëkuptim dhe dashuri, e edukon fëmijën për DYFYTYRËSI, sa për sy e faqe dëgjon dhe vepron sipas kërkesës së prindërve, por pa bindje, përcaktim, vetëm formalisht.

Ose skajimi tjetër mund të jetë *anarkist* – t'i urrejë dhe kundërshtojë të gjitha rregullat, ligjet në fëmijëri dhe në rini, sepse si fëmijë ka pësuar jetën, s'ka pasur fëmijëri dhe rini të qetë dhe të bukur.

Familjet e rrepta dhe represive edukojnë hajna, rrenca, mashtrues, kriminelë, ata të cilët s'kanë pasur përvojë dashurie, përgjegjësie, por lirin e kërkojnë në anarki dhe në shkelje të normave familjare, shkollore, shoqërore dhe fetare.

(Dritapress)

Mons. Simon Filipaj

■ SHKRUAN:

Don Nosh GJOLAJ,

SDB Podgorica

Para dhjetë viteve ndërroj jetë në moshën 74-vjeçare Mons Simon Filipaj, përkthyesi i Biblës integrale nga Vulgata e re, përkthyes i librave liturgjike si dhe autor i shumë veprave katekistike, biblike, folkloristike, etnografike si dhe përkthyes shumë veprave tjerave, si fjala vjen, veprën e Mazhuraniqit, Mark Milanit etj. Me kuptimin e plotë të fjalës disa e quajnë: "Buzuku i kohëve tona", "Jeronimi i dytë shqiptar", ose prapë "kolosi brilant i përkthimit të fjalës së Zotit në shqip", i radhitur me viganë e ndritur të kulturës shqiptare, si: Budi, Bardhi, Buzuku, Bogdani, Gjeçovi, Fishta etj. Mons Simon Filipaj, me veprën e tij madhore, la borxh, jo vetëm kishën katolike ndër shqiptarë, por mbarë kombin tonë. Dashuria për Zotin, njeriun, kulturën e popullit tonë, ishin pasioni i jetës sime" thoshte Dom Simon Filipaj. Simon Filipaj u lind më 1 maj 1925, në fshatin Kllazën e Poshtme tek Shasi i lashtë, Komuna e Ulqinit. Fillat e shkollës fillore i filloi në Selitë në vitin 1932 (dyvjeçare) pastaj e vazhdon në Katërkollë (Vladimir) të Ulqinit ku e përfundon katërvjeçaren. Ndërsa gjatë viteve 1939-41 qëndroi në seminarin e ulët në Tivar, duke ndjekur gjimnazin e atëhershëm në qytetin e Tivarit, për t'i vazhduar mësimet, gjatë viteve 1941-1945, në Shkodër, ku kryen edhe vitin e parë të filozofisë pranë Seminarit Papnor të Shkodrës për shkak të Luftës së II, studimet e tjera filozofike dhe teologjike, gjatë harkut kohor 1946-1950, i kryen në Fakultetin Teologjik të Zagrebit, si student brilant i studimeve filozofike e teologjike, i cili fliste rrjedhshëm gjuhën latine, të cilën edhe i jepte provimet. Menjëherë pas diplomimit, më 29 qershor 1950, në katedralen e Zagrebit, u shugurua meshtar (prift), kurse mëshën e parë e kremtoi në moshën 25 vjeçare në vendlindje, në fshatin Kllazna e Poshtme, ditën e Shna Prendes, më 26 korrik 1950. Dom Simon Filipaj në freskinë e jetës meshtarake, në fillim shërbeu në Malësinë e Madhe, konkretisht në Triepsh (Trieshi) e Kojë të Kuçit, në vitet 1950 - 1960; pastaj shërben për disa muaj në famullinë e Tuzit nga ku do të emërohet famullitar në Grudë nga viti 1960-1966. Më pas emë-

rohet famullitar i famullisë së Shën Gjergjit të Bregut të Bunës nga 20 nëntor 1966 - 2 shtator 1999, ishte edhe administrator i famullisë amë Kllaznes. Në kohën e pjekurisë intelektuale ku do ta përfundojnë veprën e vetë kolosale Vullgatën e re në gjuhën shqipe. Nga Shenjtëria e Tij, Papa Gjon Pali II, më 3 nëntor 1988 mori titullin e lartë "Imzot" (monsinjor) ndërsa më 6 korrik 1992, "Prelat Nderi" i Papës Gjon Pali II. Për seriozitetin e punës së tij shumëvjeçare, na flet fakti se përveç shqipes, frëngjishtes ai zotëronte kroatishten mirë edhe latinishten, greqishten e vjetër dhe italishten. Gjatë përkthimeve shërbehej edhe me hebraishten, kurse nga gjuhët e sotme në përkthime i ndihmonte mjaft, njohja e shkëlqyer e frëngjishtes dhe deri diku edhe gjermanishtes.

Imzot Simon Filipaj ndërroi jetë më 2 shtator kurse u varros me 3 shtator në varrezat e kishës "Shna Prendja në Kllazën.

FILLIMET E VEPRIMTARISË

Fillimisht duhet të theksohet Mons Simon Filipaj ishte meshtar (prift-katolik) dhe famullitar i sa famullive në hapësirën e argjeshkvisë së Tivarit. Kuptohet vetvetiu se veprimtaria kryesore dhe parësore ishte kujdesi për grigjën e besuar baritore, përkujdesja shpirtërore për famullinë që i është besuar. Një prej fryteve të tij jam edhe unë Don Noshi, i cili më drejtoi në rregullin përkatësisht kongregatën saleziane, ishte për mua meshtar ideal, kur ishte famullitar në Grudë (1964). Dom Simon Filipaj si meshtar, si intelektual, dhe si njeri ishte shumë i mirëseardhur në mesin e malësorëve të Malësisë së Madhe. Don Simoni shquhet si predikatori i shquar, folës i mirë, njeri shumë i mençëm, i papritshëm si dhe i shoqëruarshëm, pa mendje të madhe, që e përkujtojnë malësorët e Malësisë. Për hobi kishte gjetinë, përveç se u shoqëronte me besimtarët katolikë si me Gjesh Kolën Gjollaj, kishte edhe myslimanët Sadiko Merin dhe Ramë Muratin Nikaj e shumë e shumë të tjerët gjetar nga Gruda dhe gjetiu. Për ta njohur psikologjinë e një popullit, jo vetëm duhet të vizitosh besimtarët përkatësisht njerëzit e Malësisë pa dalim fejet por edhe t'i dëgjosh mendësinë e tyre si dhe përvojat shumë shekullore. Ashtu Don Simoni e ka njohur mirë të kaluarën e popullit tonë, vuajtjet shpirtërore intelektuale me të cilat populli ynë u balla-


faqua me shekuj nga pushtuesit e njëpasnjëshëm dhe duke pasur parasysh rolin që në këtë kohë të vështirë e luajti kleri katolik, vendosi të ecë gjurmëve të tyre për t'i dhënë kontributin e vet modest, kulturës shqiptare.

Në Malësinë e Madhe, ku ndër shekuj u ruajt më së shumti gjuha, tradita kombëtare dhe besimi katolik, zuri fill puna e tij intelektuale, si mbledhës i zellshëm i letërsisë gojore dhe veprimtaria e tij në përkthimin e teksteve biblike në gjuhën shqipe.

Hapat e parë të përkthimeve, të cilat nuk u botuan, ishin nga veprat e Mark Milanit "Primjeri çojstva i junastva", (ato pjesë të cilat flasin për shqiptarë), përkthimi i këngëve të Kaçiq - Mio-shiqit (ato që këndojnë lavdinë e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit Skënderbeut) dhe filloi njëkohësisht përkthimin e përrallave të Fedrit, të Ezopit dhe "Smrt Smail Age çengica" të Ivan Mazhuraniqit.

Kontributi i shumëfishtë, jo vetëm në fushën e folklorit e letërsisë gojore, por edhe në librat liturgjike dhe biblikë - Zoti flet edhe shqip!

Është me interes të vihet në dukje, se Dom Simon Filipaj krahas punës përkthyes të teksteve biblike, liturgjike me të cilat u mor në fillim, në heshtje me mbledhjen, sistemimin dhe përpunimin e gurrës popullore, pra folklorin e pasur, përmbledhje, të cilat më pas ia dorëzoi Institutit Albanologjik të Prishtinës. Vjeljes së materialeve folklorike iu përvesh në sajë të dëshirës së madhe dhe dashurisë që ushqeu për kulturën tonë popullore.



Mons. Simon Filipaj

Kështu, si i pari folklorist pas Luftës së Dytë Botërore i trevave shqiptare në Mal të Zi, arriti të shpëtoj nga zhdukja dhe harresa një grumbull të madh të këtyre visari gojor, të mbledhur me besnikëri, si: epika legjendare, balada, këngë dhe poezi popullore lirike, këngë dashurie, vajtime dhe gjemë, anekdota etj., duke i botuar ato që nga numri i parë i vjeta-

rit „Gjurmime albanologjike-Folklor dhe etnologji“, Prishtinë, 1971, 73, 74, 75, 78, 82, etj., si edhe nëpër vëllimet e posaçme folklorike, që zuri të botojë Instituti Albanologjik. Ishte po ashtu bashkëpunëtor i regullt edhe në revistën fetaro-kulturorë "DRI-TA" (1970-1991).

Krahas dëshirës së madhe për të bërë, çka të tjerët për shkak të

Don Simon Filipaj ia dhuron Biblën e përkthyer në shqip Papës Gjon Pali i Dytë



j, 10-vjetori i vdekjes

kohëve të vështira nuk arritën ta bëjnë, (si Grigor Gjirokastriti, kryepeshkvë i Durrësit, Theodor Haxhi Filipi, Vangjel Meksi, Konstantin Kristoforidhi etj., shek. XVIII-XIX), Filipajt, për fillimin e përkthimeve, të cilat i përfundoi me sukses, i ndihmoi njohja e thellë e kulturës dhe e folmeve popullore me përmasa buzukiane, ashtu i kontribuoi gjuhës shqipe më se 78 fjalë të reja, duke pasuruar leksikun e gjuhës shqipe. Madje si dhe njohës i mirë i gjuhëve biblike. Filipaj në anën gjuhësore, edhe pse pati vështirësi jo të pakta në tekstet në gjuhën semite, me sukses ia doli në krye, duke u mbetur besnik formave të përkthimit dhe duke i ruajtur veçoritë stilistike të Biblës. „Shqipja“, thoshte Dom Simoni, „ka aftësinë ta japë terminologjinë vështimplote, në përkthimin e Biblës, sikur e kanë pasur gjuhët klasike“.

Përballë këtij volumni të madh në fushën e shqipërimat, Bibla përmban dhe fjalorin e rëndësishëm të shpjegimeve me karakter teologjik, kronologjik dhe etimologjik, që i jep një shtytje të rëndësishme zhvillimit të teologjisë në gjuhën shqipe. Sipas gjuhëtarëve të shquar shqiptarë, përkthyesi, duke e bërë përkthimin e librave të Besëlidhjes së Vjetër nga „Nova vulgata“ (përkthim i Biblës në latinisht nga Shën Jeronimi, shek.IV) dhe librat e Besëlidhjes së Re nga gjuha greqishte, me mjeshtri të madhe iu përgjigj në tërësi kërkesave gjuhësore e interpretuese të gjuhës së sotme shqipe.

Punën në përkthimet e teksteve biblike dhe liturgjike, që e nisi në moshën rinore, gjatë qëndrimit të tij në Malësinë e Madhe, e përfundoi në famullinë e Shën Gjergjit buzë lumit Buna, me botimin e Biblës në tërësi, në vitin 1994, duke e kurorëzuar

kështu veprimtarinë e vet 40-vjeçare.

Bibla si vepër madhore dhe monument me përmasa botërore, përpos krishterimit, ka një rëndësi të madhe edhe për hebraizmin (Besëlidhja e Vjetër) dhe islamizmin, që lidhet ngushtë me Pesëlitrshin (Pentateuh), ose „Tevrati i Musës“, Shkrimet (Zeburët), Ungjilli (Ingjilli). Bibla përmban fjalën e Zotit, duke qenë një libër i veçantë i mbarë botës.

Nëpërmjet saj, ne si popull biblik, hymimë ndër popujt e avancuar të botës së qytetëruar, bile krenohemi me përkthimin e Vulgatës së re që ende disa shtet e ballkanike nuk e kanë të përkthyer. Disa herë autori mu ankonte: „se njerëzit do ta krahasojnë përkthimin e Vulgatës së re me Biblën kroate versioni i përkthimit „Bible de Jerusalem“ shtypur nga Krcanska Sadasnost ose nga Svarnost Zagreb, po ashtu versioni Italian „La Bibbia di Gerusalemme“ ose përkthimet e Vulgatës së vjetër. Edhe do të thonë: ‘se Don Simoni nuk ka ditë ta përkthejnë Shkrimin Shenjt!’“. Ashtu u realizuan ide profetike të Dom Simonit, veçanti disa priftë e vjetër shqiptar e vërtetën shpëreputjen me tekstin që ata posedofshin dhe e krahasofshin me tekstin në gjuhën italiane me versionin Vulgata e vjetër, që është diçka tjetër. Vërtetë Don Simon Filipaj i përdori komentet e marruar nga Bibla e Jerusalemit, sepse Vulgata e re versioni i parë ishte pa komente.

Përkthimi dhe botimi i Biblës integrale si dhe teksteve të tjera liturgjike, për çdo gjuhë, kohë dhe hapësirë është ngjarje e dorës së parë fetaro-kulturore. Duke patur parasysh lidhjen e ngushtë të gjuhës, traditës dhe kulturës shqiptare, me atë të Biblës, për

ne shqiptarët përkthimi i Biblës ka një domethënie historike.

Filipaj i palodhur iu kushtua tërësisht përkthimit të Biblës së shenjtë. Mendja dhe pena e tij e mprehtë kanë rrokur me dashuri punën përkthyes, shumë dekada me radhë. Mjedisi ku ai punoi, ishte i papërshtatshëm për një punë të tillë. Shpesh qëndronte me orë të tëra në karrigen e fortë deri natën vonë, mbi dritën e zbehtë të kandilit, apo qiriut. Sa herë që të përmendim viganët e ndritur të kulturës shqiptare, Buzukun, Pjetër Bogdanin, Pjetër Budin, Bardhin, Grigor Gjirokastritin, Konstantin Kristoforidhin, Naim Frashërin, Hoxhë Tahsinin, Atë Shtjefën Gjeçovin, Atë Gjergj Fishtën etj., nuk do të harrojmë të përmendet edhe shqipëruesi, që arriti deri më sot i vetmi, të realizojë një ëndërr 20 shekullore. Filipaj, me përkthimin e Biblës dhe librave të tjerë liturgjike, hyn si i merituar në analet e kulturës shqiptare.

Filipaj me vepërën e tij madhore, la borxh, jo vetëm kishën katolike ndër shqiptarë, por mbarë kombin tonë. Për ta ruajtur trashëgiminë përkthyes të Filipajt,

VEPRIMTARIA PËRKTHYSE E DON SIMON FILIPAJT

Katekizmi i Vogël, (përshtatur) Prizren, 1969; Ungjilli sipas Mateut, Lubjanë 1974; Besëlidhja e Re, Zagreb-Ferizaj 1980, botimi i dytë 1993, si dhe disa botime tjera; Bibla e ilustruar për të rinj, Zagreb-Ferizaj, 1978, 1988, si dhe disa ribotime tjera në Tiranë; Botimi i leximeve liturgjike (1977 – në ciklostil), tani të botuara nga „Qendra Don Bosko“ Shkodër 1994 në pesë vëllime Leximet liturgjike: Kohët e shenja, Shenjërit dhe festat, Të dielat gjatë vitit A-B-C, Gjatë javës viti I-II, Romë 1994; Meshari Romak, Ferizaj, 1991; Giacomo Gardini:




Mons. Simon Filipaj

Dhjetë vjet burgim në Shqipëri, (përkthim nga italishtja) Ferizaj -Zagreb, 1991; Rendi i Pagëzimit, Ferizaj, 1992, Rendi i martesës, Ferizaj, 1992; Rendi i Salikimeve, Ferizaj, 1992; po ashtu botimi i kryeveprës i Mons Simon Filipaj: Bibla integrale nga Vulgata e re /Besëlidhja e vjetër dhe e Besëlidhja e Re/ „DRITA“ Ferizaj, 1994 në 30 000 kopje, ribotuar në Tiranë pa komente „Bibla“ 2005; Lutjet e Besimtarëve, Ferizaj, 1995. Autor i veprave: Historiae Shëlbimit, SHPRESA - Prishtinë, 2000; Drita e vërtetë, Besoj, SHPRESA - Prishtinë, 2001, (botuar pas vdekjes). Kurse këto

ditë e panë dritën: Predikimet, Vëzhgimet Biblike si dhe Jeta e Jezu Krishtit, botuesi Argjipeshkvia e Tivarit (Ulqin 2009).

Po e përfundoi me mendimin që e paraqiti Mons Simoni në Besëlidhjen e re: „Mendimi që dikur bukur e shprehu Shën Jeronimi ‘kush shkruan apo flet (botërisht) shtien në pas ku ndër vetes aq gjuqatës sa lexues aq më i vërtetë për mua se s’ka me çka të matem ‘me të madhin Mësues’. Por, më përcjell një mendim që duket se më jep zemër dhe guxim gjithë sa bëra, e bëra për dashuri ndaj fjalës së Hyjit që të vrapoj dhe sqaroj, edhe për dashuri ndaj Kombit. Punova, pa prituri shpërblim. Net dhe ditë, ditë e kaluara në karrige të ngurtë, në dhomë të ftohtë dimrit dhe të nxehta verës, e nuk kanë qenë të pakta, nuk kërkojnë tjetër, por ta lexosh me atë dashuri me të cilën t’u përkthe. Dhe, gëzimi im do të jetë pa masë e madh, ngase mungesa e përkthimit tim do të nxisin të tjerët më të aftë se unë “në zili” (Rom II,11) për të na dhënë jo vetëm Besëlidhjen e re por mbarë Shkrimin Shenjt në një përkthim të përsosur siç e meriton Fjala e Hyjit.“

Me gojë plot mund të themi se Mons Simon Filipaj është Shën Jeronimi i ditëve tona, që e bëri që Zoti flet shqip.



Don Simon Filipaj gjatë promovimit të Biblës në Prizren



Hirësi, përshtypjet e Juaja me Nënë Tereze?

Shpeshherë e kam takuar Nënë Tereze në Romë dhe gjetiu. Isha udhëheqës edhe për kremtimin e kushteve rregulltare të motrave të saj në Romë, në Monticello. Ishte e pranishme edhe Nëna Tereze. Kam pasur këtë dhuatë dhe hir të Zotit që ta njihja personalisht. Përshtypja ime ishte kjo: vërehej menjëherë si ishte një shpirt i shenjtë, që me këmbë ecte, jetonte dhe vepron në tokë, por shpirti i saj ishte i drejtuar kah qielli. Ajo jetonte me aq përvujtëri, me aq bindje, me aq angazhim shpirtëror, që më ka entuziazmuar gjithnjë. Gjithmonë i kujtoj me kënaqësi të veçantë takimet që i kam pasur me Nënë Tereze. Përshtypja ime ishte se e kam takuar një Shenjtëreshë.

Ju si Prefekti i Kongregatës për Shpalljen e Shenjtërve keni pasur edhe momentin e dytë të hirit për ta takuar për së afërmi nëpërmjet hulumtimeve të ndryshme deri te faza për t'ia paraqitur Shenjtërit Atë Papë Gjon Pali II këtë lëndë. Si i keni përjetuar ju dhe bashkëpunëtorët tuaj këto dëshmi, takime?

Vërtet i kam përjetuar si momente të thella shpirtërore, me kënaqësi dhe me entuziazëm, sepse unë gjithmonë kam parë në Nënë Tereze të Kalkutës një shpirt të veçantë. Puna dhe kontributi që deshi Zoti që unë ta bëja për të, që Nëna Tereze të vinte deri te nderi i elterit, e konsideroj si hir dhe dhuatë të posaçme. E kam përcjellë këtë çështje me entuziazëm të madh, me përjetim dhe thellësi të madhe shpirtërore. Lumturimi i Nënës Tereze do të ishte një dhuatë e madhe për mbarë Kishën katolike dhe botën. Bota e sotme ka nevojë për shpirta si ishte Nëna Tereze e Kalkutës, që tërësisht i

kushtohen Zotit dhe njeriut, të afërmit si vëlla apo motër. Ajo ka jetuar me dashuri dhe ka dashur duke vepruar sipas vullnetit të Zotit. Mu për këtë puna që e kam bërë për Nënë Tereze ishte kënaqësi e jashtëzakonshme. Kur ishte takimi me Komisionin e teologëve për t'i studiuar dhe shqyrtuar virtytet e saj teologjike, pastaj takimi me Komisionin e mjekëve për të vërtetuar shërimin e mrekullueshëm, për mua ishte gëzim i madh shpirtëror, si dhe shpresa që sa më parë të vinte momenti i lumturimit të saj. Kur Papa Gjon Pali II e ka shkurtuar afatin e pesë viteve kanonike pas vdekjes për fillimin e procesit dhe të hulumtimeve, për mua ishte një gëzim i madh. Ajo ishte e para që e theu këtë kufi për fillimin e procesit të lumturimit. Pastaj Papa Benedikti XVI ka lejuar këtë për Papën Gjon Pali II si dhe për motrën Lucia nga Fatima. Papa ishte i frymëzuar prej Zotit për ta bërë këtë hap, kuptohet, gjithnjë për të mirën e Kishës dhe të botës. Kjo punë, me shumë hulumtime dhe dëshmi është përmbledhur në 80 vëllime me nga 450 faqe, domethënë gjithsej 36.000 faqe, të cilat dëshmojnë njëzëshëm për virtytet e saj të larta dhe heroike të jetës së krishterë, për dashurinë kulmore flijuese dhe vetëmohuese për të mirën dhe dobësinë e njerëzve të varfër ndër më të varfër.

Tani është koha e pritjes për vazhdimin e procesit deri te shenjtërimi i Nënës Tereze. Në cilën fazë gjendet ky proces? Ju mendoni dhe shpresoni se për 100-vjetorin e lindjes së saj, në vitin 2010, mund ta kemi Shën Nënë Tereze me titull të plotë?

Unë vërtet mendoj dhe shpresoj që kjo është e mundshme, që këtë përvjetor të madh ta kremtojmë me shenjtërimin e

Intervistë me Hirësinë e Tij kardinalin Jose' Saraiva Martins, Prefekti i Kongregatës për Shpalljen e Shenjtërve në Romë

Nënë Tereza - ylli dhe pasqyra, të cilën mund ta shikojnë dhe ndjekin të gjithë

së Lumes Nënës Tereze të Kalkutës. Shpresoj me gjithë zemër. Për shenjtërimin nevojitet edhe një mrekulli. Pra duhet studiuar ndonjë mrekulli eventuale të Nënës Tereze nga ana mjekësore, nga teologët dhe Komisioni i kardinalëve, si dhe nga Kongregata e Shenjtë. Flitet për një mrekulli të mundshme, eventuale, që thuhet se ka ndodhur me ndërmjetësinë e Nënës Tereze. Kjo çështje së pari studiohet nga ana e mjekëve, nga dy mjekë ekspertë, të cilët do të na thoshin se ia vlen të shtrohet studimi dhe shqyrtimi i hollësishëm mjekësor. Që një shërim të jetë mrekullor, duhet të jetë i menjëhershëm, i tërësishtëm, i vazhdueshëm, i pashpjegueshëm nga ana natyrore e mjekësisë dhe e shkencës aktuale. Nëse mjekët do të na thoshin këtë, atëherë lënda kalon në shqyrtim të teologëve, pastaj edhe të Komisionit të kardinalëve. Pra, nuk mund të kemi parashikime, sepse çdo gjë varet prej Këshillit mjekësor dhe shëndetësor, prej teologëve, për të arritur të shkalla e tretë, të kardinalëve. Unë besoj dhe shpresoj se ky përvjetor përkujtimor do të jetë i ndriçuar dhe i zmadhuar edhe më tepër me kanonizimin, shenjtërimin e së Lumes Nënës Tereze. Do të ishte kulmore kremtimi më i madh për Kishën dhe për botën.

Pyetja e fundit: Nëna Tereze ishte me prejardhje nga prindërit nga Kosova, ka lin-



“Përshpirtëria e saj, humanizmi i saj i thellë, dashuria e saj flijuese dhe dhuruese, mund të jetë një shenjë e paqes për të gjithë popujt.”

“Nëna Tereze e Kalkutës është shenja e paqes dhe pajtimit, bashkëjetesës në mes të popujve.”

dur në Shkup, në Maqedoni. Nëna Drane dhe motra Aqe kanë vdekur në Tiranë gjatë sundimit dhe përndjekjeve komuniste në Shqipëri. Ajo disi ka lidhur dhe bashkuar botën shqiptare, Kosovën, Maqedoninë dhe Shqipërinë, trekëndshin tonë, si fryti i Kishës 2000-vjeçare, Kishës, e cila ka pësuar deri më sot shumë martirizime. Për ne ajo është ngushëllimi i Zotit si dhe pranimit i të gjitha flujveve tona shekullore, shenjë se Zoti i ka pranuar dhe shpërblyer flujimet tona. Çka mendoni Ju?

Unë mendoj se Nëna Tereze e Kalkutës është shenja e paqes dhe pajtimit, bashkëjetesës në mes të popujve. Në muajin qershor isha në Liban për lumturimin e një maroniti. Këtë lumturim të gjithë libanezët e kanë përjetuar si shenjë të paqes... Unë këtë shembull e aplikoj edhe për Nënë Tereze. Për mua Nëna Tereze është një yll që mund të ndriçojë mendjen dhe zemrën e shumë popujve në viset tuaja, popuj kaq bujarë, kaq të vuajtur, por me një fe dhe përsëritje të lartë. Nëna Tereze mund të jetë ylli dhe pasqyra, të cilën mund ta shikojnë dhe ndjekin të gjithë. Uroj që Nëna Tereze të jetë faktori i paqes për këta popuj, sepse Nëna Tereze ishte dhe është kjo, Nëna e Paqes. Përsëritja e saj, humanizmi i saj i thellë, dashuria e saj flijuese dhe dhuruese, mund të jetë një shenjë e paqes për të gjithë këta popuj të dashur. Ne i nderojmë dhe admirojmë ata për guxim, për fe dhe për karaktere-

rin e tyre. Nëna Tereze e ka një funksion të rëndësishëm për këta popuj, shtete, që t'i zbatojnë parimet dhe përsëritjet e saj. Nëna Tereze thoshte që shenjtëria është detyrë për të gjithë dhe në një mënyrë shumë të thjeshtë: ta mësojmë dashurinë dhe kështu do ta mësojmë edhe shenjtërinë. Për këtë të gjithë kemi nevojë, si në nivelin personal, po ashtu edhe në nivelin e popujve. Dashuria dhe pajtimi janë parakushtet e paqes së qëndrueshme, e cila bazohet në drejtësi, e jo në interes, si thonë dhe bëjnë shpesh njerëzit e politikës... Popujt jetojnë në paqe nëse iu japin përparësi këtyre vlerave njerëzore dhe kristiane... Është i njohur rasti i gazetarit pikërisht këtu në Romë, kur ndër të tjera e pyeti kështu: "Si e ndieni veten që njerëzit, bota t'iu thërrasë shenjtëresbë për së gjalli?"... Ajo iu përgjigj kështu: "Shenjtëria nuk është një luks për pak njerëz, por është një nevojë, edhe më tepër një detyrë për të gjithë, për mua dhe për ty!". Nëna Tereze e ka kuptuar shumë mirë se shenjtëria është në dashurinë ndaj Zotit dhe ndaj të afërmit... Ajo ka pasur edhe në aspektin teologjik intuicionin e mrekullueshme dhe shumë aktuale.

Hirësi, unë Ju falënderoj për zemërsisht për këtë intervistë, për vlerësimet tuaja të ndritshme, për atë çka na keni dhuruar, sepse jeni personi më kompetent për të vlerësuar Nënë Tereze, jetën, veprimtarinë, përsëritjet, shenjtërinë e saj, sidomos aktualitetin e saj. Mendoj se ajo është

Shenjtëresha e cila gjatë shekujve do të jetë gjithnjë aktuale për Kishën dhe mbarë botën.

Pa dyshim. Nëna Tereze do të jetë gjithmonë aktuale, sepse shenjtëria e saj është metahistorike apo metafizike, tejkalon çdo kohë dhe çdo hapësirë. Kjo vlen për çdo shenjt, sidomos për Nënë Tereze. Ju falënderoj Juve për 13 libra dhe botimet e bukura dhe të pasur mbi Nënë Tereze që mi keni dhuruar mua dhe Kongregatës tonë. Në një mënyrë Ju e keni kryer rolin e "postulatorit" para postulatorit zyrtar atë Brian Kolodiejchuk-it. Po ashtu Ju falënderoj për filmin dokumentar që po e bëni për televizionin tuaj të Kosovës. Kështu më së miri nderohet e Lumja Nëna Tereze duke e bërë atë të njohur dhe të pranueshme në mendjen dhe zemrën e mbarë popullit.

Ju falënderoj për zemërsisht dhe shpresoj që të jeni në mesin tonë për 100-vjetorin e lindjes së Nënë Tereze. Pas dy viteve ne shpresojmë që do ta kemi edhe katedralen e Nënë Tereze në Prishtinë, në Kosovë.

Me kënaqësi dhe me shumë vullnet! Dhashtë Zoti! Rrnoftë Kosova!

Jeni Profesor i madh, Kardinal i madh, Njeri i madh i Kishës!

(Intervistoi dr. Don Lush Gjergji; intervista u realizua në Vatikan me 17 shtator 2008)

Kush janë shenjtërit apo shenjtëreshat?

Shenjtërit apo shenjtëreshat janë nxënësit shpirtërorë të Jezu Krishtit, të cilët e kanë kaluar jetën tokësore me besnikëri dhe dashuri të jashtëzakonshme dhe si të tillë janë dalluar për të mirë dhe me të mirë gjatë shtegtimin apo udhëtimin tokësor. Ata mu për këtë janë shembull i ndritshëm i *virtutëve themelore të jetës së krishterë, fesë, shpërsës dhe dashurisë*, si ndaj Zotit, Krijuesit dhe Shëlbuesit tonë, po ashtu edhe ndaj çdo njeriu, si model të jetës së krishterë.

Çka janë Shërbëtorët apo Sherbëtorët e Zotit?

Shërbëtorët apo Sherbëtorët e Zotit janë ata të krishterë të vdekur, të cilët kanë lënë gjurmë bindëse në rrethin e tyre në jetën e krishterë, si të tillë dukshëm janë dalluar prej të tjerëve, dhe tani me iniciativë apo nisë të Kishës vendore, fillon faza e grumbullimit të dokumentacionit, të dëshmive, të hulumtimeve teologjike për të hulumtuar dhe vërtetuar këtë famë apo namë shenjtërie.

Çka është lumturimi?

Lumturimi është shpallja zyrtare e Papës ndaj një personi, i cili i ka zbatuar virtutet e jetës së krishterë në shkallën më të lartë apo heroike gjatë jetës tokësore. Ky proces bëhet së pari në nivelin ipeshkvor apo ndëripeshkvor, dhe vetëm pas përfundimit pozitiv dërgohet në shqyrtim të mëtejshëm në Romë.

Roma apo Vatikani pas analizave të shumta dhe të hollësishme në aspektin teologjik, kalon në fazën e shqyrtimit të ndonjë mrekullie nga ana e komisionit shkencor ndërdisciplinor ndërkombëtar. Mrekullia pranohet vetëm atëherë kur ndodh ndonjë shërim i menjëhershëm, i plotë, i paepërsëritshëm, i pashpjegueshëm me anë të shkencës dhe të medicinës. Atë përpos Komisionit shkencor e aprovon Komisioni teologjik, Komisioni i Kardinave, dhe së fundi e vërteton zyrtarisht edhe Papa.

Vetëm pas shpalljes apo lumturimit fillon nderimi zyrtar, urata, mesha në Kishën Katolike. Papa personin e shpallur të Lumt apo të Lume e shënon në Listën apo Kanunin e të Lumturve.

Pas lumturimit nevojitet edhe një mrekulli për ta shpallur dikë shenjt apo shenjtëreshë.

Çka është kanonizimi apo shenjtërimi?

Kanonizimi apo shenjtërimi është shpallja kremtoare e Papës me autoritetin më të lartë të Kishës Katolike të ndonjë shenjt apo shenjtëreshë dhe shënimi në

Listën apo Kanunin e shenjtërvë.

Të Lumët nderohen vetëm në vende të caktuara, ndërsa Shenjtërit apo Shenjtëreshat në mbarë Kishën Katolike.

Çka janë reliket?

Reliketet janë diçka e lidhur ngushtë me të Lumin apo të Lumen, Shenjtin apo Shenjtëreshen, si për shembull flokët, eshtrat, veshja, gjërat që i kanë përdorur apo prekur gjatë jetës së tyre.

Reliketet ndahen në tri grupe apo njësi:

Kategoria e parë janë pjesët e trupit, si gjaku, flokët, eshtrat; Kategoria e dytë janë gjërat që i kanë përdorur apo prekur;

Kategoria e tretë janë gjërat që në ndonjë mënyrë direkte apo indirekte ishin në lidhje me personin e Lum apo të Shenjtë, apo edhe me varrin dhe me relikvijet e tyre.

Përse i nderojmë reliket?

Nderimi i relikvijëve është një traditë e lashtë kishtare qysh nga koha e martirëve të parë të krishterë e kohës apostolike. Ato nuk kanë ndonjë fuqi magjike, por tek besimtarët zgjojnë nderim, falënderim dhe ndërmjetësim për ne para Zotit, kuptohet, nëse vërtet besojmë dhe me zemër lutemi apo kërkojmë ndonjë hirë apo ndonjë të mirë.

Çfarë kuptimi ka nderimi ndaj relikeve?

Nderimi ndaj relikeve në rend të parë është *shprehje e fesë në jetën e pasosur* për ata që besnikërisht kanë jetuar sipas mësimin të Jezu Krishtit dhe Kishës Katolike.

Po ashtu dëshmojnë dhe përforcojnë *fenë në të ngjallurit e korpit – trupit dhe në jetën e pasosur për të gjithë*, kuptohet, pas Gjyqit të mbramë apo universal.

Nderimi i relikeve të shenjtëve apo shenjtëreshave njëkosisht tregon *edhe nderimin ndaj trupit të njeriut*, Tempullit të Zotit, si gjatë jetës njerëzore dhe tokësore, po ashtu edhe pa vdekjes apo kalimit në amshim.

Ky nderim dëshmon *fenë e krishterë në ndërmjetësimin e shenjtëve apo shenjtëreshave para Zotit*, gjë që shprehet me besimin në Shoqërinë e Shenjtëve. Lidhja jonë si Kishë në shtegtim me Kishën e lumturuar, ata që e kanë arritur plotësisht planin e krijimit, shëlbim apo jetën e pasosur.



Muzika shqiptare

(Vështrim i shkurtër)

■ SHKRUAN:
Prof. mr. Vinçenc GJINI

Muzika e kultivuar shqiptare

Muzika popullore e çdo populli është themel i vërtetë i zhvillimit të muzikës së vet artistike, do të thotë se ajo ka luajtur rol dërmues në krijimin e kulturës artistike muzikore. Prandaj, edhe tek ne, krijimtaria e muzikës popullore gjithmonë ka shfaqur nxitje gjallëruese për krijimtarinë muzikore profesioniste. Ajo ka mundësuar krijimtarinë e organizmeve të reja, edhe më të larta.

Në muzikën burimore popullore nuk ekziston *harmonia tonale* dhe kompozitorë të caktuar, të cilët krijojnë në frymën e muzikës popullore, apo shërbehen me citate folklorike, kërkojnë rreth harmonive të *fshehura* (latente), të cilat i përshtatën akoma më shumë frymës së melodive popullore. Këtu, në plan të parë, vijnë elementet modale. *Melodika* e muzikës popullore shqipe, siç kemi përmendur, më së shumti bazohet në elementet e *shkallëve të vjetra* (modet), në *pentatone*, etj.

Format e ndryshme të lëndës së parë folklorike nuk janë thjesht dukje materiale muzikore, por gjithmonë ato janë edhe intelektuale e shpirtërore.

Pra, në dobi të traditës sonë muzikore, modet e vjetra që rrojnë në popullin tonë, duhet të ruhen dhe të stolisën me petkun e fisnikëruar artistik. Ky mbetet si një problem shumë i rëndësishëm për ruajtjen dhe konsolidimin e tipareve kombëtare, në lartësinë e një dukurie estetike që le gjurmë të qarta në përpunimin e figurave të gjalla artistike. Ky

proces i gjatë e i thellë kushtëzon dukjen e strukturave artistike të përbëra e të shumëllojshme.

Sipas kohës që ka zgjatur praktika e *krishterimit* të popullit shqiptar (që nga shek. I të erës së re), mund të mendohet se në trojet tona ka qenë e zhvilluar një jetë shpirtërore e kulturore me krijimtari origjinale kishtarë, krijimtari që ka ardhur nga ndikimi i ndërsjelltë e kryqëzues i *kishës* dhe i *popullit*. Gjithashtu mund të mendohet që muzika profane ka qenë e lidhur ngushtë me fenë, po për këtë nuk kemi ndonjë trashëgim të spikatur kulturor.

Hulumtuesi, Prof. **Ramadan Sokoli** është tempull, burrë i madh i kombit shqiptar, njeri i kulturës dhe qytetërimit tonë. Hulumtimet e tij prekin mbishkrimet parahistorike të shpellave e deri te muziktarë që s'njohin kufij kohe as vendi. Me hulumtimet dhe shkrimet që i bëri, ai na pruri në dritë disa fakte tejet të rëndësishme për historinë dhe kulturën tonë të lashtë. **Niket Dardani**, arbër, ilir i Dardanisë, është autor i *Te Deum laudamus* ("Lavdërojmë Zotin tonë"), si edhe **Jan Kukuljeli**, arbër prej Durrësi, emër i madh i botës së muzikës i pragut të Mesjetës. Është reformator i këndimit dhe i notacionit muzikor. Supozohet se elementet e muzikës së tij rrjedhin nga tradita folklorike dhe kishtarë popullore.

Antifonari i durrsakut **Gjergj Danush Lapacajt** (njeri shumë i ditur) është një kodik në pergamene, 23 vjet më i moçëm se Meshari i Buzukut. "Ky është një përmendore muzikologjike që dëshmon se në pellgun e Adriatikut gjallonin tradita kulturore e artistike të begata". Nga muzgu i Mesjetës "ne kishim një traditë liturgjike vendase" (citete të R. Sokolit).

Natyrisht, sipas mendimit tim, këto mbetën të jenë vetëm teori hipotetike, pasi që këto dokumente historike vetëm *përkrasin* autenticitetin e tyre. Këto kërkojnë një gjurmim studioz dhe vëzhgim solid shkencor.

Etapat e caktuara historike (politike, ekonomike, dyndjet, luftërat, pushtimet e popujve të lashtë fqinjë, shpërngulja, shfaqja, qëndresa, etj., etj.) kanë ndikuar mbijetesën e gjatë të popullit autokton të Ballkanit, Ilirëve të lashtë. Prej Ilirëve janë trashëguar shumë elemente kulturore të një qytetërimit të lartë. Tokat Ilire kanë qenë mullë grindjeje me popujve të lashtë romakë, grekë e më vonë sllavë e osmanlinj dhe kjo ka ndikuar shkatërrimin e pozitës së tyre të atëhershme sociale, politike, kulturore e fetare. Shumica e popullit mbeti pa vatër, pa atdhe, pa rrënjë. Mirëpo, ata nuk hoqën dorë nga identiteti historik kombëtar e kulturor, të cilin e ruajtën ndër shekuj me sakrificat të mëdha.

Kështu, të ilirët është shfaqur së pari qëndresa e natyrës kulturore, sepse përkishtë duke mbrojtur *faqen* e duke ruajtur *gjuhën*, ata luftuan për identitet, liri dhe për *pavarësi* tërësore. Ndërkohë, në rrugën e gjatë historike ata e mësuan mirë se vdekja e kulturës së tyre do të thoshte njëherësh, edhe fundin e tyre, kështu që tek ta lulezuan ndërthëritet e pafund e të shumëllojshme kulturore.

Vendet tona janë territor tepër i shumëllojshëm në kuptim gjeografik, trafik, ekonomik, demografik, kulturor etj. Kjo ka bërë që edhe zhvillimi kulturor të jetë i lidhur me shumë komponente të brendshme e të jashtme e të sjellin si rrjedhojë aspekte të larmishme e të shumanshme të kulturës në përgjithësi, e në mënyrë të veçantë, të muzikës.

E ndërtuar mbi muzikën e pasur e të shumëllojshme folklorike krahinore dhe në zhvillimin paralel stilistik të muzikës perëndimore evropiane dhe e mbështetur në talentin e individëve të veçantë, muzika shqiptare me *kuptim profesionist* është krijuar me kontinuitet që prej shek. XX. Këtu lirisht mund të themi se në Shqipëri dhe vendet tjera tona, rol tejet të rëndësishëm dhe kontribut të posaçëm *nismëtar*, për zhvillimin e *muzikës së kultivuar*, ka dhënë *kleri kishtar*, jo vetëm për muzikën fetare, por edhe atë laike e origjinale të gjinive të ndryshme. Muzika kishtarë e katolikëve është bazuar në elementet e *choralit gregorian*, ndërsa ajo ortodokse në elementet e

muzikës *bizantine*.

Këtu është e nevojshme të përmendet kontributi dhe aktiviteti *kishtar*, pastoral, kulturor, arsimor e shkencor i disa personaliteteve qendrore të kulturës gjithëkombëtare, të cilët luajtën rol të rëndësishëm në të zgjuarit e vetëdijes kombëtare e të cilët lanë gjurmë në historinë tonë të lavdishme. Do të veçonim vetëm disa klerikë, të cilët me vetëdijen e tyre të lartë kombëtare, kanë qenë mjaft të zellshëm, por, kuptohet, jo po aq të njohur e të shfaqur në mënyrë publike. Me veprat e tyre ata kanë lartësuar dhe begatuar gjuhën, letërsinë, artin dhe përgjithësisht kulturën shqiptare. Për kontributin e dhënë në veçanërisht në artin e muzikës mund të përmenden emra të tillë të nderuar të kulturës muzikore të kultivuar si Martin Gjoka, Fan S. Noli dhe Mikel Koliqi.

Gjatë dhjetëvjeçarit të dytë të shek. XX u shfaq nismëtar kryesor i muzikës profesioniste të shqiptarët, padër **Martin Gjoka**. Ai është njeriu i parë që ka filluar të kompozojë muzikën klasike të zhanreve të ndryshme. Kompozoi vepra polifonike, sidomos për kore, si edhe një simfonitë të pakryer (*Dy lule mbi varrin e Shënderbeut*). Ndër të tjera kompozoi himnin e Flamurit kombëtar "*Porsi fleta e gjllit t'Zotit*" (1913).

Fan S. Noli ka qenë krijues dhe person i gjithanshëm. Edhe në muzikë ka kontribuar me disa kompilime të parafrazuara të muzikës liturgjike, por edhe me vepra origjinale: "*Shënderbeu*", poemë simfonike për orkestrë, *Uvertura Bizantine* për orkestrë, këngë korale, disertacioni "*Bee-thoveni dhe revolucioni francez*" etj.

Mikel Koliqi, intelektual i gjithanshëm, kompozoi disa *melodrama* (embrion i operetës shqiptare!), të cilat më pas me mjeshtri i përpunoi kompozitori Tonin Harapi.

Elementet folklorike dhe mbështetja në intonacionet e muzikës së hershme kombëtare, në veprat e kompozitorëve tanë të përcaktuar për shprehjet e tyre nacionale, janë përfaqësuar në masë të ndryshme nga autorë të ndryshëm. Ato përdoren si burim i materialit tingëllyes, si *frymëzim artistik* dhe si vërtetim i identitetit personal e kolektiv. Këto elemente, gjithsesi ndikojnë në formimin e fizionomisë së autorit. Krijuesit e mprehtë të muzikës, me talent e shkathtësi *stilizojnë idiomat popullore* dhe krijojnë me to, ndjeshmërinë e një forme bindëse e origjinale.

Zhvillimi historik ka caktuar

që aspiratat e dalluara e të pavarura nacionale (ideologjike, politike dhe të lëvizjeve shoqërore të rretheve partikulare) nëpërmjet të krijimtarisë kulturore të shfaqen edhe te ne. Në këtë zhvillim shumë ka ndikuar liria shoqërore dhe liria e kufizuar e shoqërisë dhe e njerëzve në të shprehurit kreativ kolektiv dhe individual. "*Kjo muzikë u formua prej modelsh ideologjike të 'njeriut të ri', 'pushtetit të ri', 'psikologjisë së re' kombëtare e demokratike...'*". Kështu ka ndodhur që në Shqipëri, në kohën e politikës së ditës, kushtëzimit marksist të ndërgjegjes shoqërore të njerëzve, muzika të shfaqet kryesisht si "*muzikë me program*", dhe kështu, relacioni, të cilin muzika artistike shqiptare e vendosi, sipas tradicionalizmit, në esencë është tradicionaliste ose restaurative.

Në përgjithësi, duke mbajtur parasysh situatat bashkëkohore të zhvillimit të muzikës dhe marrëdhëniet e kompozitorëve shqiptarë me to, krijuesit tanë përfaqësojnë dy drejtime kryesore:

Kompozitorë *tradicionalistë* dhe

Kompozitorë të *drejtimit të ri muzikor*.

Për të dy këto drejtime kompozitorët mbështeten në traditat e vjetra e të reja evropiane. Secili në mënyrë individuale, ata kryejnë një barazpeshë të qëndrueshme të elementeve tradicionale dhe atyre avangarde. Disa prej tyre, nga format dhe mendësitë e vjetruara kërcejnë në koncepte krejtësisht të reja dhe praktikojnë një gjuhë të re muzikore të natyrës shprehëse ekspresioniste, ndërsa të tjerë, nuk kanë veçori individuale të profilizuara e të unifikuara. Ata fusin veçori kombëtare në gjuhën universale të muzikës së kultivuar dhe ruajnë folklorin autentik dhe shprehjen e identitetit nacional.

Tek ne fillimet kanë qenë modeste dhe në një masë të madhe, zhvillimi i muzikës së kultivuar është lidhur me daljen e njerëzve të talentuar e të kulturuar, të cilët kanë sjellë vepra të vlefshme muzikore. Në temat e tyre citohen meloditë popullore, qoftë në formë variacionesh përpunuese, qoftë mbi bazat e formave tradicionale. Shprehja harmonike është e shumëllojshme. Përdoren harmoni të veçanta, me gjuhë të qartë e kryesisht diatonike. Shumica e kompozitorëve mbështetet në parimet estetike të drejtimit të cituara më sipër dhe ky është një stimul i rëndësishëm për zhvillim.

Ndërkaq, është fakt që theme-



let e para progresive të formimit të muzikës së kultivuar shqiptare i hodhi një brez i tërë krijuesish të shquar shkodranë si **Prenkë Jakova** (autor i operës së parë kombëtare *"Mrika"* dhe i operës *"Gjergj Kastrioti Skënderbeu"*); bardit **Çesk Zadeja***, (erudit dhe *"babai"* i muzikës klasike shqiptare), **Tonin Harapi** e **Tish Daija** (autor i baletit të parë shqiptar *"Halili dhe Hajria"*); **Pjetër Gaci** dhe të tjerë. Të gjithë këta personifikuan në veprat e veta prirjet kombëtare të muzikës shqiptare përmes veçorive personale e individuale.

Në shek. XX arrin një brez i ri kompozitorësh të arsimuar në Çeki, Bashkimin Sovjetik, Shqipëri, Jugosllavi e vende tjera, të cilët, përmes veprave të shquara profesioniste synojnë një pluralizëm stilistik të krahasuar me proceset e ngjashme evropiane. Ndër zërat e spikatur të kësaj

jet e idiomave harmonike kombëtare me mprehtësinë moderne bashkëkohore. Duke shkatërruar sistemin funksional të harmonisë klasike, ata krijojnë terren të veçantë për trajtimin e saktë harmonik të melosit popullor. Në opuset e tyre vërehen sintezat e të gjithë ndikimeve të reja dhe të rëndësishme, d.m.th. vazhdim i dinamikave modale e ritmike, i koncepteve politonale dhe i praktikave bitonale, si dhe karakteristikat ritmiko-melodiko-harmonike. Këtu dallohen Çesk Zadeja, Feim Ibrahim, etj. Krahas mjeteve të reja muzikore ata kërkojnë të ruajnë shprehjen folklorike dhe të krijojnë kështu, sa të jetë e mundur, gjuhë personale e individuale.

Disa prej tyre, në mënyrë të natyrshe, hyjnë brenda eksperimenteve dhe organizimit të përgjithshëm të muzikës avantgarde. Ndër ta, disa janë radikalë

ni e të tjerë. Ky brez kompozitorësh të rinj shqiptarë, pa asnjë mëdyshje, shfaq një gjeneracion të talentuar, emrat e të cilëve, po bëhen përditë e më të lakmuar në aktivitetet e rëndësishme të vendit dhe ndërkombëtarë.

Të rinjtë vijnë kryesisht nga shkollat e kompozimit në Akademinë e Arteve të Tiranës, Prishtinës, Beogradit, Sarajevës, Shkupit, Lubjanës, Moskës, Krakovit, Parizit, Romës, Londrës, Gjenevës, Curihit, etj.

Pa dyshim, nga begatia e vepërave muzikore të kompozitorëve shqiptarë, një numër i konsiderueshëm do të mbetën monumente të qëndrueshme të kulturës sonë muzikore kombëtare, duke respektuar dhe përdorur metodologjinë hulumtuese dhe përpunimin shkencor të shënimeve. Mes tyre do të ketë, padyshim, edhe nga ata që do të zveniten prej kohës. Por do të ketë edhe të

“Pa dyshim, nga begatia e veprave muzikore të kompozitorëve shqiptarë, një numër i konsiderueshëm do të mbetën monumente të qëndrueshme të kulturës sonë muzikore kombëtare, duke respektuar dhe përdorur metodologjinë hulumtuese dhe përpunimin shkencor të shënimeve.”

periudhe mund të përmenden: Lorenc Antoni, (melograf dhe kompozitor), Avni Mula, Nikolla Zoraqi, Mark Kaçinari, Vincenc Gjini, Feim Ibrahim, Krist Lekaj, Akil Koci, Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri, Zeqirja Ballata, Rauf Dhomi, Shpëtim Kushta, Kujtim Laro, Thoma Gaqi e shumë të tjerë. Shumica e krijuesve që i përmendim kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë edhe sot një potencial i rëndësishëm kulturor me angazhim (profesional dhe amator) të cilësuar për kulturë masive, duke zbatuar detyra të shumëllojshme si: muzikantë, dirigjentë, kompozitorë, muzikologë, publicistë, pedagogë, nxitës të kulturës dhe traditës popullore muzikore shqiptare, etj.

Rrjedhat më të reja, në aspektet nga fryma e re evropiane, janë reflektuar edhe në krijimtarinë e kompozitorëve profesionistë shqiptarë. Në muzikën e vet aplikojnë, idiomat të një koncepti kombëtar dhe shprehjet politonale të një thelbi akustik modal. Këto sjellin aspekte të rinj dramatikë, deri edhe në shprehjet e konsoliduara tradicionale si ato të gjinive të ndryshme koncertale, të kuartetit për harqe, apo edhe të koncertit instrumental. Disa prej kompozitorëve asimilojnë elementet modale me tingëllima arkaike dhe i zhvillojnë në lidh-

je të tjerë të përmblajtur. Përdoret tonaliteti i zgjeruar (sistemi kromatik), elementet strukturorë dodekafonike, strukturat akordike kuarto-sekundore, etj. Mirëpo, kjo muzikë sjell njëherazi edhe aspektet e veta specifike, të kushtëzuara nga rregullat e hapësirës shpirtërore prej nga rrjedhin krijesit e saj.

Në përgjithësi, brezi i kompozitorëve të rinj të stilit neokombëtar, por edhe i kompozitorëve që i janë drejtuar shprehjeve moderne bashkëkohore, është një brez i ri krijuesish me vizion të qartë evropian, i cili synon që, pamjen e moderuar të gjuhës dhe të shprehjes e drejton kah parimet e përgjithshme universale të epokës së sotme evropiane. Krijimtarinë e vet filloj një grup i fuqishëm i cili drejtohet kah shprehja bashkëkohore muzikore, të bazuar në pasurinë e ideve nacionale. Ata me vepra të veta krijojnë bazën për grupe të reja kompozitorësh të këtij shekulli. Këtu kishim me i vargue e përmendë disa krijues të dalluar, si që janë: Aleksandër Peçi (i njohur jashtë vendit, opera *"Oirat"*), Sokol Shupo, Vasil S. Tole (opera *"Eumenidët"*), Endri Sina, Rafet Rudi, Gjon Gjevelekaj, Bashkim Shehu, Bahri Mulliqi, Mendi Mengjiqi, Baki Jashari, Valton Beqiri, Ilir Bajri, Laura Çupërija-

tillë që do të hyjnë në antologjinë e muzikës shqiptare, si dokument i përhershëm i muzikës sonë kombëtare.

E gjithë kjo është arritur gradualisht dhe po vete normalisht, duke krijuar parakushte parafike, të kushtëzuara të muzikës profesioniste. Formohen shkollat e muzikës, akademitë e muzikës të cilat stimulojnë zhvillim të krijimtarisë muzikore dhe të reprodhimit, dhe kështu këto sjellin rrjedhoja konkrete. Ky proces i profesionalizimit së jetës muzikore stimuloj edhe institucionet muzikore të reja: operën, filharmoninë, teatrin, radio dhe TV stacionet, të cilat, në programet e veta mjaft veprojnë në zhvillimin e kulturës muzikore, e njëherit stimulojnë dhe afirmojnë veçanërisht kreatorët e ri.

Në mungesë të muzikantëve të vendit, të profleve të ndryshme (dirigjent, instrumentist, koncert mjeshtër, solist, këngëtarë, etj.), si ndihmë, në vendet tona vijnë muzikantët e shtetëve të huaja, të cilët, secili në mënyrë të vet dhe sipas specialitetit, ndihmon dhe kontribuon në zhvillimin dhe përparimin kulturor të këtyre vendeve, si pjesë trashëgimtare të mbarë njerëzimit.

(FUND)

Recension

“Besojmë me Etërit e Kishës”

Etërit e Kishës janë shkrimtarët, teologët, dijetarët e Kishës që nga shekulli IV pas Krishtit, të cilët kanë shqyrtuar dhe shpjeguar çështje të ndryshme fetare dhe morale sipas mësimave dhe parimeve ungjillor dhe Traditës së krishterë. Shkrimet e tyre quhet edhe patristika, dhe na dhurojnë interpretime mjaft burimore të Biblës, veçanërisht të Ungjillit dhe Veprave të Apostujve, si dhe të shkrimeve tjera nga Besëlidhja e Re, ndërsa ata i quajmë edhe Dijetarët e Kishës.

Elementet kryesore që i përcaktojnë Etërit e Kishës janë:

Mësimi dhe doktrina burimore, e cila mbështet në vetë porosinë e Jezu Krishtit dhe të apostujve, si dhe në Traditën kishtarë.

Përpos kësaj kërkohet edhe shenjtëria e jetës, që domethënë që mos të mësojnë vetëm me fjalë apo me shkrime, por atë që mësojnë ta dëshmojnë dhe përforcojnë edhe me jetën e vërtetshme të krishterë.

Pëlqimi apo aprovimi nga ana e Kishës, domethënë që mësimet dhe shkrimet e tyre janë në përkim të plotë me parimet ungjillore, me magjistrin apo mësimin e Kishës, Papët, si dhe me Koncilet e ndryshme.

Lashësia, që tashmë dihet saktësisht, dhe që për Perëndim është vdekja e Shën Isidorit nga Sevilja (636), ndërsa për Lindje vdekja e Shën Gjon Damascenit (diku rreth vitit 750). Dijetarët dhe Etërit e Kishës ishin kryesisht ipeshkvij, pra, njerëz të uratës dhe të pendës, të cilët me autoritetin e tyre apostolik i kanë shpjeguar dhe shpallur guximisht dhe besnikërisht të vërtetat e shëlbimit, si zë burimor dhe me autoritet hyjnor i Kishës Katolike.

Rëndësinë e tyre e vërtetojnë edhe koncilet e ndryshëm në të cilët janë definuar të vërtetat kryesore të fesë së krishterë, dhe ku Etërit e Kishës patën shpeshherë fjalën meritore dhe vendimtare.

Këtë qëndrim e ka pasur edhe Koncili i Dytë i Vatikanit, si dhe Katekizmi i Kishës Katolike, ku ndër të tjera thuhet se Shkrimi Shenjt dhe Tradita janë një gjë e vetme për zbulimin dhe dhurimin e të vërtetave të fesë dhe të moralit të krishterë.

Aktualiteti i tyre është në



afërsinë me kohën apostolike dhe Traditën e Kishës së Parë apo të hershme, si dhe në misionin, detyrën dhe shërbimin ipeshkvor, po ashtu një numër i madh i tyre janë edhe martirë, që edhe më bindshëm vërtetën dhe përforcon mësimin dhe porosinë e tyre. Nga ky këndvështrim ata ishin egzegetët apo interpretët e besueshëm të Fjalës së Zotit, të urtisë shpirtërore, e cila nuk është më “pronë e të dijes njerëzore”, por e fuqisë dhe frymëzimit hyjnor, që na zbulon dhe dhuron planin e shëlbimit për mbarë njerëzimin e çdo kohe apo hapësire. Gjurmëve të tyre do ta gjejmë më lehtë dhe më mirë Rugën, të Vërtetën dhe Jetën, Jezu Krishtin, Gurrën e pashter-shme të Dashurisë, të Faljes, të Shëlbimit.

Don Marjan Demaj e ka bërë një punë tejet të mirë, shumë të nevojshme dhe të dobishme, sepse na ka afruar Etërit e Kishës neve dhe kohës, rrethanave tona, dhe nëpërmjet tyre na ka mundësuar njohjen, pranimin, zbatimin dhe dëshmimin e vetë Jezu Krishtit, e së bashku me Të dhe me Kishën, “Nënë dhe Mësuuesen”, jetësimin e porosisë ungjillore dhe jetës së krishterë.

Shpresoj dhe uroj që Etërit e Kishës të na ndihmojnë në përformimin e fesë, në ngjalljen e shpresës dhe në ndezjen e dashurisë për Zotin dhe njëri-tjetrin, dhe si të tillë për dhurimin e dëshmisë së krishterë të gjithë njerëzve vullnetmirë dhe në kërkim të Vetvetes dhe të Vërtetës.

(Marrë nga parathënia e librit)

Shën Gjon Vianney meshtar sipas Zemrës Hyjnore

■ PËRGATITI:
Don Albert DEMAJ

Shën Gjon Maria Vianney u lind në Francë afër Lionit më 8 maj 1786. Tejkalo i shumë vësh-tirësi para shugurimit meshta-rak më 13 gusht 1815, ku më pas iu besua një famulli e barruar e Arsit, fshat me 230 besimtarë. Ipeshkvi i vendit i tha: *Pak ka dashuri ndaj Zotit në atë famulli. Ju duhet patjetër ta sillni aty dashurinë e Zotit.* Ai ishte i vetëdijshëm që duhet për ta dëshmuar prezencën e Krishtit dhe mirësinë apo mëshirën e Zotit, andaj edhe lutej *O Zot, më jep kthimin e famullisë sime. Jam i gatshëm krejt jetën të vuaj që do të ti dëshiroj!* Me këtë lutje shën Gjoni e nisi misionin e vet.

Biografi i tij i parë thotë: *Menjëherë pas ardhjes në famulli, kishën e zgjodhi si shtëpi. Në kishë hynte para agimit dhe nuk e lëshonte para darkës, gjeqësisht lutjes së Engjëllit Tenzot. Në kishë duhej kërkuar kush do që kishte nevojë për të.*

Famullitari i Arsit besimtarët e vet i mësonte me dëshminë e vet. Nga shembulli i tij, besimtarët mësuuan lutjet e bile edhe të adhuronin Krishtin në kishë. *Nuk duhet me folë shumë për t'u lutur mirë, thoshte, e dimë që Krishti është në tabernakull. Le t'ia hapim zemrat, le të gëzohemi në praninë e tij. Dhe i thërriste besimtarët: Ejani në kungim, vëllezër dhe motra, ejani të Krishtit. Ejani jetoni prej Tij, që të jetoni me Të. Natyrisht që nuk jeni të denjë, por ju keni nevojë për Të.*

Rregullisht i vizitonte familjet dhe të sëmurët, organizonte festa të ndryshme. Bashkëpunonte ngushtë me laikët dhe tubonte ndihma me qëllime bamirësie, sidomos për shkollimin e bo-njakëve. Në mënyrë të veçantë u kujdes për fëmijët jetimë dhe mësuesit e shoqatës *Provania* që e kishte themeluar vetë.

Meshtar sipas Zemrës Hyjnore

Ishte i vetëdijshëm se si meshtar është dhanë e jashtëzakonshme për popullin e vet, modest, i përzemërt dhe shumë i dashur për të gjithë thoshte:

Bariu i mirë, meshtarë sipas Zemrës Hyjnore, është thesari më i madh që Zoti mund t'i japë një famullisë, dhe një nga dhuratat më të çmuar të hirit të Zotit.

Duke iu shpjeguar besimtarëve të vet rëndësinë e sakramenteve, thoshte: *Pa sakramentin e*

urdhrit të shenjtë, nuk do ta kishim Krishtin, dhe pyeste: Kush e vë atë në tabernakull? Meshtari. Kush e ka përshëndetur shpirtin tuaj në fillim të jetës suaj shpirtërore? Meshtari. Kush e ushqen shpirtin tuaj dhe e forcon në rrugë? Meshtari. Kush e bekon dashurinë tuaj në martesë? Meshtari. Kush do ta përgatisë atë për takim me Zotin, duke e larë për herë të fundit në Gjakun e Krishtit? Meshtari dhe gjithmonë meshtari. Dhe nëse ndonjë shpirt duhet të vdesë për shkak të mëkatit mortar, kush do ta shpëtojë, kush do t'ia ripërtërijë dhe lirojë shpirtin duke ia kthyer pagën? Prapë meshtari.... Vetëm në qiell tërësisht do ta kuptojmë se kush është faktikisht meshtari.

Shenjtëro ditën diel e ditën festë të urdhëruar!

Një nga veset e shumta të Arsit, ishte edhe mos respektimi i të dielës dhe festave të tjera. Andaj një ditë shën Gjoni iu tha besimtarëve të vet: *E diela është dita e Zotit të dashur! Ai i ka krijuar të gjitha ditët e javës, ka mundur të gjitha t'i ndal për veti, por Ai iu ka dhënë juve 6, e për veti e ka ndalë vetëm një. Me qfarë të drejte prekni në atë që nuk iu takon? Mirë e dini që gjësendi i vjedhur nuk iu sjell kurrë dobi. Dita që doni t'ia vërdhni Zotit, nuk do t'iu sjellë dobi. I njoh dy gjëra të sigurta që do t'iu sjellin deri te shkopi i varferisë: hajnia dhe puna të dielave!*


Ata që kanë marrë pjesë në meshë të këtij famullitari të shenjtë, dëshmojnë se nuk kanë mundur të gjejnë shembull më të mrekullueshëm të liturgjisë... shikonte në hostje me dashuri të pafund.

Ishte i bindur se entuziazmi i jetës meshtarake varet në tërësi nga mesha shenjte. *Të gjitha veprat e mira, të krenuara së bashku, nuk vlejnë sa mesha shenjte, sepse janë vepra njerëzore, ndërsa mesha shenjte është vepër e Zotit. Dobësi e meshtarit është që nganjëherë nuk i jep kujdes të duhur meshës shenjte. O Zoti im, sa duhet të vuajmë për meshtarët që meshën shenjte e shërbëjnë në rutinë.*

Meshtari nuk është meshtar për veti, ai është meshtar për ty!

Ndjenja e tij e përgjegjësisë si meshtar ishte shumë e theksuar: *Sikur këtu në tokë të kuptonim plotësisht se çka është meshtari, atëherë do të kishim vdekur, jo nga frika, por nga dashuria... Pa meshtarin vuajtja dhe vdekja e Krishtit do të ishin të padobishme. Meshtari është ai që në botë e vazhdon veprën e shëlbimit... Çfarë dobie nga shëlbim*

“ **Bariu i mirë, meshtarë sipas Zemrës Hyjnore, është thesari më i madh që Zoti mund t'i japë një famullisë, dhe një nga dhuratat më të çmuar të hirit të Zotit.** ”



me plot ari, nëse nuk ka kush me e bapë? Meshtari i ruan çelësat e thesarit qiellor, meshtari është ai që i bap dyert, ai është mbarështues i Zotërisë dhe i të mirave të tij... Lëreni famullinë 20 vite pa meshtarë dhe ata do të fillojnë të adhurrojnë egërsirat. Meshtari nuk është meshtar për veti, por për ty!

Duke kaluar shumë orë në kishë para tabernakullit, i frymëzonte besimtarët që ta imitojnë duke ardhur në kishë për ta vizituar Krishtin. E dinin se famullitari i tyre ndodhej në kishë i gatshëm për t'i dëgjuar dhe për t'i falur. Më vonë numri i të

penduarve vinte nga tërë Franca dhe meshtarin e palodhshëm e mbanin në kishë edhe nga 16 orë. Flitej se si Arsi u bë një spital i madh shpirtëror.

Një herë një kolegut të vet meshtarë ia shpjegoi pse është aq i dobët në shëndet: *Po ta jap recetën time: Mëkatarëve u jap pak pendesë, unë vetë e kryej pendesën për mëkatet e tyre. Ishte shumë i prekur duke e ditur se shpirtin ishin të shëlbuar me gjakun e paçmueshëm të Krishtit, e meshtari nuk mundet plotësisht t'i kushtobet shëlbimit të tyre nëse e refuzon të ndajë çmimin e shenjtë të shëlbimit të Krishtit.*

Nga Papa Benedikti XVI

Papa në letërn e vet, duke e hapur Vitin e Meshtarisë, nën mbrojtjen e këtij shenjtë të madh, ideal që ne meshtarët duhet ndjekur në përditshmërinë tonë, komentoi: *Në kohën e vet famullitari i Arsit arrite t'i ndërrojë zemrat dhe jetën e njerëzve, sepse ua krijonte mundësinë ta përjetonin mëshirën dhe dashurinë e Hyjit. Koba jonë urgjentisht kërkon një shpallje të ngjashme dhe dëshmi të Dashurisë së vërtetë, sepse Zoti është dashuri. (Gjn 4,8)*

Në fund Papa thotë: *Virgjëres së shenjtë ia besoj Vitin e meshtarisë. E lus që të zgjojë në zemrën e çdo meshtarit përkushtinë e madhe të idealit të shenjtë të dhurimit të plotë Krishtit dhe Kishës që e nxiti dhe frymëzoi jetën dhe veprën e famullitarit të shenjtë të Arsit.*

Arsi sot

Shekuj pas vdekjes së këtij shenjtë në Ars është e ndërtuar një shenjtërore e mrekullueshme e *Zojës së Hireve*, kurse në kapelën e *Zemrës* ndërrohen reliket e këtij shenjtë. Trupi i tij i paprishur qëndron në altarin kryesor të Shenjtërores në relikuiarin e xhamit. Shtëpia e thjeshtë e këtij shenjtë tani është muze. Sipas statistikave çdo vit këtë vend e vizitojnë mbi 400.000 shtegtarë.

Duke iu falënderuar meshtarëve tanë në Zvicër që çdo vit organizojnë shtegtim në Lurd, shenjtërore e *Zojës Bekuar*, në të kthyer për Zvicër, shkojnë në këtë vend të shenjtë. Kështu para disa viteve pata nderin dhe kënaqësinë e veçantë të jem dhe të udhëheq meshën shenjte në këtë shenjtërore të madhe të shën Gjon Vianey me disa meshtarë tanë dhe shtegtarët e Luridit.

Përndryshe, kisha famullitare në Binçë, si pajtor të dytë e ka këtë shenjtë të madh.

Shën Gjon Maria Vianney – lutu për ne!

Të biesh në dashuri dhe të dashurosh

■ SHKRUAN:
Mihály Szentmártoni

Dashuria është nevojë e përhershme e çdo njeriu. Vetëm se ndoshta format shprehëse të kësaj nevojë ndryshohen. Për këtë arsye mund të tingëllojë tashmë monotone një përsëritje e vazhdueshme „të rinjtë dhe dashuria“, sikur bëhet fjalë për njëfarë privilegj të tyre. E pra, mbetet fakti se pikërisht në rini ndodhin disa vendime të fatit në bazë të dashurisë, më saktë, në bazë të dashurisë heteroseksuale. E këto vendime, sipas natyrës së vetë çështjes, janë të papërsëritshme, të mos themi të papërmirësueshme. Këtë na e dëshmojnë martesat e dështuara. Ndoshta personi do të gjendet diku tjetërkund, të themelojë një familje të re, mirëpo pasojat e martesës së parë të dështuar vazhdimisht ndjehen si lëndime psikike. Nëse këtë e kuptojmë, na bëhet e qartë rëndësia e këtij problemi tek të rinjtë.

Në takim të personit tjetër

Për ta kuptuar vendin dhe rolin e dashurisë në jetën e të rinjve, njëkohësisht detyrën e prindërve dhe edukuesve, duhet thënë diçka në përgjithësi mbi karakteristikat e asaj faze zhvillimore.

Për dallim nga puberteti, që i tëri ka qenë në një zierje të caktuar, në rini shenja karakteristike bëhet *stabilizimi i instinkteve vitale*. Kjo para së gjithash

shfaqet me një të kthyer më të madh kah bota e jashtme, kah të tjerët. Vërehet nevoja për miqësi, për kontakt me njerëz të tjerë. Mbyllja në vetvete dhe padurimi ndaj të tjerëve, që e kanë karakterizuar pubertetin e vonshëm, gradualisht shndërrohen në një të kthyer kah të tjerët që kulmin e vet e arrijnë në aspiratën për bashkim.

Qëllimi më kryesor i zhvillimit të deritanishëm psikik ka qenë të gjeturit e vetvetes, „unit“ të vet. Edhe në personin tjetër njeriu i ri në të vërtetë e ka kërkuar veten, „unin“ e vet, dhe gjithçka i ka shërbyer kësaj. Orientimin e ri, në të kundërtën, e karakterizon çiltëria pikërisht për tjetrin si tjetër: „uni“ kthehet dhe çelet kah „ti“. Njëkohësisht zhvillohet aftësia për altruizëm, besnikëri dhe shpirt vetëmohues.

Me rëndësi është të vërehen disa dallime ndërmjet të rinjve dhe vajzave në atë periudhë për sa u përket marrëdhënieve ndërnjerëzore. Nevojat e tyre janë të ndryshme. Të rinjtë, si meshkujt në përgjithësi, gjithmonë më mirë ndjehen në grupe (tubime) të mëdha. Dëshirojnë të jenë në *time* (grupe), iu pëlqen të kenë miqësi të mëdha dhe të zgjeruara. Janë të kënaqur nëse kanë një ose dy shokë të afërm. Kur nuk ka një grup stabil të moshatarëve, zhvillimi i personit mashkullor është i ngatërruar. Rrezik më i vogël është për të riun nëse nuk e ka një shok të përhershëm, nëse nuk mund të futet në asnjë grup. Vajzat kanë më shumë nevojë për marrëdhënie person-person se

“ Dashuria në thelb është të kthyerit kah personi tjetër për shkak të vlerave të tij shpirtërore ”

sa djemtë. Pa këtë raport mund të heqë keq gatishmëria e tyre për vendosjen e kontakteve heteroseksuale. Grumbujt e mëdhenj këtë nuk mund ta zëvendësojnë.

Ngjarje tjetër e rëndësishme në adoleshencë është *të përkryerit e zhvillimit psikoseksual*. Për pubertetin kulmor ka qenë karakteristikë e posaçme se erosi ka qenë i kthyer kah personat e të njëjtës gjini: djali është ndjerë i sigurt vetëm në shoqëri të djemve, kurse vajza në shoqëri të vajzave. Grupet e përziera janë përjetuar si të panatyrshme dhe në to të rinjtë s’e kanë ndierë veten mirë. Në adoleshencë fillon të kthyerit kah personat e gjinisë së kundërt. E këtë të rinjtë tanimë duhet ta mësojnë. Për sa i përket kësaj qasjeje, situata e adoleshentit është më e volitshme se sa ka qenë në pubertet, sepse edhe shoqëria - në të vërtetë, brenda kufijve mjaft rreptësisht të caktuar moralë - ua pranon të drejtën në qasjen e personave të seksit të kundërt. Diku në fillim të adoleshencës të rinjtë tashmë shkojnë në kërcime, ndoshta e vijnë edhe shkollën e kërcimit, ku, përveç kërcimit, mësojnë edhe mënyrën e qasjes dhe të kontaktuarit me personat e gjinisë tjetër.

Prej flirtit të dashuria

Në qasjen e personave të rinj të seksit tjetër mund t’i vërejmë disa faza karakteristike.

Faza e para e qasjes ndaj seksit tjetër ndodh në formën e *flirtit*. Flirti (loja dashurore) është sipërfaqësore, sipas natyrës së vet ende është një lidhje jo e përhershme. Në flirt personi ende nuk është „i prekur“, nuk është i kapur në thellësinë e qenies së vet. Ende nuk shikohet në vlerat e vërteta të personit tjetër si person, por qëllimi është vetëm afërimi. Kjo është marrëdhënie për shkak të vetë marrëdhënies. Flirti është vërtet një lojë ngacmuese me zjarr, kontaktim provues pa qëllime të sinqerta. Me atë rast djemtë janë rëndom aktivë, kurse vajzat më pasive. Ato në përgjithësi presin ose e provojnë tërheqjen e vet: *koketojnë*. Në koketimin ato njëkohësisht partnerit i japin zemër dhe e habisin, e tërheqin dhe e dëbojnë.

Faza e dytë e qasjes është *të rënë në dashuri*. Për të rënë në dashuri është e veçantë se në vend të parë gjithnjë qëndron pamja trupore e partnerit: zëri, lëvizjet etj. Ky është rast kur ende mund të thuhet: „Të dua për shkak të kësaj dhe asaj: për shkak të shtetit, zërit, mënyrës të së ecurit, flokëve, fuqisë, syve etj.“ Meqenëse është i magjepsur nga jashtë, i dashuruari është i verbër për veset e karakterit të tjetrit, për ç’arsye herët a vonë lind zhgënjimi. Mirëpo, si në të dashuruar personi ende nuk është i kapur në thellësitë më të thellat të qenies, nëpër zhgënjim relativisht lehtë kalohet. Erosi lirohet për objektin e ri. Është e njohur se personi mund të dashurohet në mënyrë të vërtetë shumë herë.

Faza e tretë e qasjes është *dashuria*. Rregullisht lajmërohet më vonë, mirëpo shpesh herë qysh në adoleshencë. Për dallim nga të rënë në dashuri, ajo nuk rri në sipërfaqe, por del nga thellësia dhe hyn në të. Dashuria në thelb është të kthyerit kah personi tjetër për shkak të vlerave të tij shpirtërore - të karakterit. Prej këtu lind qëndrimi i ndryshëm ndaj personit të dashur, se ç’ka qenë ky rast në të rënë në dashuri, para së gjithash përhershshmëria më e madhe e marrëdhënies, pastaj përgjegjësia për personin tjetër dhe thellësia më e madhe e të përjetuarit. Nëse kemi thënë për të rënë në da-

shuri se orientohet sipas parimit „të dua për shkak të kësaj apo asaj“, për dashurinë vlen parimi „të dua *përkundër* të gjithave“.

Dashuria e moshës djaloshare i ka veçantitë e saj. Ajo aspiron kah *idealizimi* i personit të dashur. Në të i sheh të mishëruara të gjitha vlerat në formën më të kulluar. E sheh të ngritur përmbi të përditshmen e vrerët. Në mënyrë të ngjashme edhe e tërë bota e merr një shkëlqim më të ndryshëm, një kolorit të ri: personi nuk e sheh më me sytë e vet, por me sytë e personit të dashur.

Tipari i dytë i dashurisë së moshës djaloshare është përfaqësimi i fuqishëm i *mekanizmit të projekcionit*. Realizimin e të gjitha aspiratave dhe ëndrrave të veta personi i vendos në personin e dashur. E etiketon me kualitete dhe vlera të tilla që në të vërtetë ai nuk i posedon, por paraqesin dëshira, ëndrra. Për atë arsye ndjen se e ka takuar dikë tashmë kaqherë të njohur. Ky është ai i famshëm „princi ose princesha nga përralla“, i cili sikur po del nga ëndrrat në zhgënjendërr. Për fat të keq, ky projekcion i paraftyrimeve personale nuk është krejtësisht i parrezikshëm, sepse domethënë të shikohet në personin tjetër në dikë që nuk ka ekzistuar kurrë. Me siguri është kjo një prej shkaqeve që shumica e lidhjeve martesore të hershme njëjtë hershme edhe dështojnë.

Edhe në të rënë në dashuri ka disa dallime ndërmjet djaloshit dhe vajzës. Për vajzën lidhjet e para afektive rëndom përfundojnë në dhembje, pikëllim dhe në zhgënjim. Domethënë, kur vajza dashurohet, hyn në lidhjen afektive, ajo dëshiron që kjo lidhje të zgjasë amshueshëm. Djemtë, ndërkaq, edhe pse mund të deklarojnë se edhe ata e dëshirojnë po të njëjtën gjë, në të vërtetë këtë nuk mund ta realizojnë para se të paraqitet periudha e të rriturit. Domethënë, detyra kryesore psikike në adoleshencë për ta është përshtatja sociale. Nuk janë të gatshëm ta pranojnë përgjegjësinë e përhershme para se të ndjehen të sigurt në planin profesional.

(vijon)

(Marrë nga libri: *Mihály Szentmártoni, Bota e të rinjve. Përkthet: P. Shtjefën Dodes SJ*)



“Jeta është dhuratë e jetës” – Thirrja për Kurorë të Martesës së Shenjtë për të rinjtë e sotëm

Në qoftë se plotësimi i jetës ka domethënë të jetohet jeta porsì dhuratë, njeriu e arrin pjekurinë kur të bëhet i aftë të dhurojë jetën e vet. Bëhet fjalë për detyrën më me përgjegjësi, për një provim më efikas dhe më të zorsbëm për ta kaluar gjatë jetës dhe në të cilin “të ngelësh” nuk janë pak të tillë.

■ PËRGATITI:
Don Lekë OROSHI, sdb

Bëhet fjalë për të mësuar idealin e të jetuarit, e të diturit, ditë për ditë, të bëhesh dhuratë e jetës për jetën e dikujt tjetër, ndaj të tjerëve që të mund të jetojnë nëpërmjet dhuratës të jetës tonë. Ai që nuk është në gjendje të jetojë apo të përmirësohet në këtë dimension martesor në dashuri, mundet të ketë gjithsesi në mënyrë anagrafike një moshë “madhore” apo të “pjekur”, mundet ndoshta edhe të jetë i pasur dhe i famshëm, por është dhe mbetet i paformuar dhe i papjekur komplet, një person i realizuar përgjysmë dhe ndoshta edhe më pak. Për këtë dimensionin martesor në dashuri ajo e dhuratës së jetës për të dhuruar jetë, e bashkon shumë thirrjen në kurorë të martesës porsì ajo në shugurim për të krijuar me Zotin një “familje shpirtërore”.

Janë dy mënyra shumë të ndryshme, dhe komplet për nevojat e njerëzimit dhe të Kishës, të jetohet në të njëjtin realitet.

Kështu pra, për ata të rinj, të cilët hynë në moshën e pjekurisë, Zoti thotë të “lejë babanë e vet, dhe nënën e vet”, në kuptim të një realiteti që shpesh edhe bëhet apo shndërrohet në një burg komod, për të hyrë në moshën e pjekurisë. Pra, bëhet fjalë të lehtë mosha ku vetëm janë pranuar gjërat për të hyrë në atë ku duhet të dihet të dhurohet. Vetëm kështu njeriu realizon në plotësi thirrjen themelore të të jetuarit

në një imazh të Zotit. Të jetohet me dinamikë ajo “e dhuruar” dhe ajo “e pranuar” don të thotë pra, të jetohet në mënyrë njerëzore dhurata Hyjnore, e Zotit tonë dhe e Jezu Krishtit, pra, Hyji i jonë është Trini e Shenjtë në relacion dinamik, një Bashkësi Dashurie krejt e Pastër dhe me plot Kuptim. Zoti që është Unitet – Bashkë jo një vetmi absolute, por një Unitet i Bashkimit të Dhuratës reciproke dhe Perfeksionit i Personave, i Atit dhe i Birit dhe i Shpirtit Shenjtë, Plotësi në Harmoni të Përsosur.

Në Atë që është Dhuratë për madhësi, një Dhuratë, e cila e hap dhe e plotëson kuptimin e vet në vet Trininë Shenjtë, kështu që është Dashuri nëpërmjet Zotit, krijon dhe gjithmonë shenjtëron botën dhe çdo njeri.

Kështu pra, duke qëndruar në leximin e Zanafillës, e cila e hap Biblën, pikërisht që natyra e gjallë e mban në vetë shenjtën, imazhin e Jetës Hyjnore, Zoti ka krijuar dallimin dhe plotësimin e gjinive. Dhe kështu në mes gjallesave duhet të jetë ndokush në gjendje të imitojë Zotin, jo vetëm në dinamikë të një jete, e cila është reciproke dhe relacionale në natyrë të saj, por edhe të një reciprociteti të të jetuarit lirshëm dhe në vetëdije të plotë porsì dhuratë e vetvetes, Zoti e ka thirrur njeriun të pranojë dhe të integrojë gjininë e vet natyrore në dimensionin Shpirtëror të DASHURISË.

Në qoftë se duam të gjejmë një mënyrë klasike dhe shumë bindëse definicionin e dashurisë,

ajo ka për të gjetur lumturinë e vet kur e bën të lumtur tjetrin. Dashuria është prandaj e finalizuar në jetë, në plotësim edhe të jetës të tjetrit dhe të vetvetes. Më shumë, e ka mbëri pjekuri në perfekte në mënyrë njerëzore ai i cili e di që plotësimi i jetës së vet kalon paqetë në plotësim të jetës së tjetrit, të tjerëve.

Kurora e Martesës atëherë nuk është ajo rregulla “qesharake”, ose “institucionale”, e cila është nën kontroll për qëllime sociale të nevojshme apo për instinkt edhe seksual. E kundërta, martesë është momenti ku çifti, pas një ecjeje apo përgatitjeje paramartesorë të domosdoshëm, është i thirrur të inaugurojë një epokë të re të dashurisë së tyre, e cila do të zgjasë për gjithë jetën. Një epokë apo periudhë të integritetit të dy dimensioneve të dashurisë, pra, dimensionin fizik dhe ai dimension sentimental afektiv, në atë shpirtëror të zgjedhjes së lirë për t’u dhuruar që të jenë “një”.

Një unitet në ndryshim të personave që të shpërndahet dhe dhurohet të tjerët: fëmijëve të tyre (sipas vullnetit të Zotit), mandej prindërve – familjarëve të çiftit edhe në moshën e vjetër të tyre, dhe kështu mbarë të afërmeve dhe të gjithë njerëzve të cilët kanë nevojë për ta, mbarë familjes së krishterë dhe jo të krishterë, të “hapur” ndaj nevojave dhe ndihmave që u kërkohen, duke u vu nën shërbim të të gjithëve. E tërë kjo do të thotë të formosh familje. Dy dritëza që shndërrohen në një “qytet të vogël”. Një qytet i vogël i pozicionuar në një majë beshke për të shënuar rrugën atyre që nganjëherë e humbin atë dhe gjatë natës, porsì një qytet më i madh i Kishës ku pikërisht Familja është shenja dhe realiteti.

Dhe nëpërmjet kësaj zgjidhjeje të lirë dhe personale të DASHURISË, e cila bëhet dhuratë dhe ajo vetë bëhet nxitje për bashkim dhe unitet. Pra, një unitet dinamik, i cili, porsì zjarri, ndikon që të shpërndahet dhe transformon. Të duhen “përgjithmonë” nuk do të thotë të fosilizohen. Në qoftë se do që Dashuria të zgjasë përgjithmonë, duhet që ajo porsì zjarri të gjejë gjatë gjithë moshave të ndryshme të jetës nxitje të reja që të mund të ndizet, në qoftë se nuk vepron kështu, bëhet një tangar gacash plot me vaj dhe vuajtje. Prandaj, Dashuria duhet të jetë e shndërruar gjithmonë njëri ndaj tjetrit.

Është nëpërmjet kësaj zgjidhjeje të lirë të DASHURISË – dhuratë – përgjithmonë – për – të – gi-

“Hyji krijoi njeriun në përngjasimin e vet, e krijoi në përngjasimin e Hyjit; i krijoi mashkull e femër. Hyji i bekoi dhe u tha: “Shtohuni e shumojuni e mbusheni tokën dhe sundojeni atë! Bëhuni zotëruesit e peshqve të detit, të shpendëve të qielit dhe të çdo gjallesë që lëviz përmbi tokë!” (Zanafilla 1, 27 – 28).

thë, sidomos për të rinjtë, të cilët kanë nevojë sot më shumë se kurdoherë për formim dhe lutje që kjo Dashuri të jetë e pjekur. E tërë kjo themelohet në Hirin që Zoti jep atyre që e kërkojnë dhe lejojnë.

Nganjëherë dëgjohej: “gjithçka ka mbaruar” apo “nuk të dua më” – apo fjali stereotipike të përsëritura në tv, në telenovela, në romane, nëpër internete, nëpër këngë të ndryshme, ku fatkeqësisht historia e shumë martesave ka përfunduar edhe në kohët e menjëhershme – na bën të kuptojmë që e tërë kjo është e vështirë që çifti të jetë në gjendje të ngrihet në nivel të duhur të dashurisë vetëm me forcat e tyre, fizike apo vetëm sentimentale pa atë dimensionin shpirtëror të Hirit.

Prandaj, më dashurinë dhe sentimentet e Krishtit gjithçka është e mundur dhe e besuar.

Pa këtë, sa vajza, nëna dhe shumë gra të tjera kanë ra në gracka të së keqes: aborti!

Sa djem, etër të familjeve, burra të ndryshëm kanë ra në mëkatet të rënda: kurvëria, keqpërdorimet e ndryshme!

Çka është pra kurora e martesës, o të rinj? Është një palestër e dashurisë, shkolla e madhe e jetës me të cilën Zoti na mëson në njerëzit që të jemi porsì Ai: në imazh të Tijën na krijoi, mashkull dhe femër na krijoi. Pra, ia vlen të regjistrohemi dhe të shkruhemi në këtë shkollë dhe mbi të gjitha të mundohemi të frekuentojmë duke kaluar kriza dhe provime dhe vështirësi të vogla dhe të mëdha? Përgjigjen na e jep Psalmi me vullnin më të madh të lutjes: o Hyj, bën që unë mos të mbes i habitur në përfjetësi (Ps. 71.1)!

Kur gabohet apo kur mbesim të habitur ... “të gabosh është njerëzore”, do të më kundër-

shtojë. Është e vërtetë, mund të ndërmjetësojmë ndaj gabimeve tona bazore. Mund të na kaplojë rreziku në habi të tillë, ku dëshpërimi të na bëhet pa ndërmjetësim. Pra, cili mund të jetë zhgënjimi më i tmerrshëm? Ndoshta është puna, aktiviteti, të hollat, fama, shëndeti?... hup, e mos të mendojmë në marrina të tilla. Nuk ka fatkeqësi më të madhe, e cila mund ta kaplojë një njeri ajo kur e vëren që nuk ka qenë i dobishëm ndaj askujt në jetë! (këtë gjë e kanë vërtetuar edhe mendimtarët më të mëdhenj të botës).

Ja pra, martesë, ruga e dhurimit të jetës personale për të dhënë jetë dikujt tjetër, të tjerëve të cilët varen nga ne, është ruga e madhe që Zoti e ka gdhendur në trupin tonë, psiken tonë dhe shpirtin tonë, të çdo njeriu, të çdo gruaje, që secili të ketë mundësi të ikë nga “dështimi radikal” në Unitet të jetës!

Vetëm dashuria e pranuar dhe ajo e dhuruar, Dashuria me “D” të madhe të shtypit dhe falas, vetëm Ajo është e Vërteta. Pikërisht Ajo, e cila është Palas, është Ajo e vërteta dhe e pambaruara. Duajeni njëri me tjetrin thotë vetë Krishti.

Gjërat u thanë dhe metoda e veprimit është e qartë, prandaj urime të rinj.

“Mvendos si vullë mbi zemrën tënde, porsì vullë mbi dorën tënde se dashuria është e fortë si vdekja,

i pashmangshëm është si dheu i zi lakmimi; vapa e saj si vapa e zjarrit, flakë hyjnore! Ujërat e mëdha dashurinë nuk mund ta ndalin, nuk e fikin as lumenjtë!

Kush do të jepte gjithçka ka në shtëpinë e vet me qëllim të bërë dashurinë, do të përbuzej prej gjithkujt.”

(Kënga e Këngëve, 8, 6-7)



Domethënia e disa simboleve (e përgatitur enkas për fëmijë)

Hiri

A e di se çka është hiri? Ajo çka mbet prej një dege të djegur. Nëse e merr në dorë, përlësh. Hiri të sjell ndërmend shkatërrimin e apo djegien. Është pra shenjë e shkatërrimit dhe e vdekjes. Siç po sheh, nga ana e jashtme nuk ka asgjë të mirë në hi. Megjithatë, edhe ai ka një kuptim pozitiv. Të ndihmon në meditim. Para një grushti me hi, çfarë mendimi të vjen? Nuk të vjen dobësia e gjërave dhe e njeriut.

Në faqen a parë të Biblës tregohet se "Hyji e formoi njeriun prej pluhurit të tokës" (Zan 2,7). A e di se ky është edhe kuptimi i fjalës "Adam"? E ky do të jetë edhe përfundimi i tij: "do të kthehesh në tokë, sepse prej saj që nxjerrë (Krh. 3,19). Do të kthehemi e të bëhemi një grusht pluhuri!"

Si mund të jetë njeriu krenar? Koncepti që e shpreh më së miri realitetin tonë dhe që e realizon plotësisht quhet përvujtëri. Edhe vetë fjalë tregon: në gjuhën italiane fjala 'umilta' vjen prej fjalës latine 'Humus', që do të thotë tokë.

A e kupton tani pse të kam thënë që edhe hiri mund të ndihmojë në meditim tënd: na kujton se ne jemi pluhur dhe pluhur do të kthehemi. Njeriu nuk është i ligshhtë vetëm në trupin e tij, subjekt i sëmundjeve të ndryshme dhe në kalimin e viteve plakët. Ai është i ligshhtë edhe në shpirt: nuk flas për sëmundjet mendore, por për ligësi që e çojnë njeriun në mëkat. Jemi të ligshhtë në trup dhe jemi mëkatarë.

Edhe një herë tjetër hebrejtë e kanë kuptuar domethënien e

hirit. Prej shumë shembujve po ta rikujtoj sidomos një atë banorëve të Ninivës përballë predikimit të Jonës: "besuan në Hyjin, bënë pendesë, u veshën më thasë dhe uleshin mbi pluhur" (Krh Jona 3, 3-6). Tani edhe mund të kuptosh pse Kisha e propozon në fillim të kreshmëve vënien e hirit mbi kokë. Domethënia e zbulon në vetë fjalët që meshtari i thekson në këtë rast: "kujto o njëri që pluhur je e pluhur do të bëhesh"; ose "Ktheu dhe besoji ungjillit" (Mk 1,15). Por kujdes të lutem, nuk është një gjest që duhet të nxit trishtimin.

Menjëherë pas karnavaleve, moment i shfrenimit dhe pamendësisë, riti i të përthiturit i hap fillimin e Kreshmëve që na dërgojnë drejt festës së Pashkëve. Fillimi i një udhëtimi thërret paqetë të qëllimit. Pra, edhe e mër-kura e përhime nuk do të qëndrojë si diçka e shkyçur, por që do të marrë jetë dhe gjallëri. Ti e di se dheu - Adami me frymën e Hyjit u bë njëri i gjallë, ashtu edhe pluhuri ynë sot, me forcën e Shpirtit të shenjtë, që e ka ngjallur edhe Jezu Krishtin, na dërgon tek Ringjallja.

Po të propozoj një slogan: kalimi prej hirit në flakë e në ujë. A e di se çka do të thotë? Kreshmët fillojnë me gjestin e të përthiturit dhe mbarojnë me simbolin e flakës dhe të ujit në natën e Pashkëve. A të kujtohet se çfarë të kam thënë në fillim të këtij meditim? Hiri i përlën duart, ndërsa uji i pastron dhe është burim jete. Nuk është edhe krejt e çuditshme që të afrohen hiri dhe uji nga se edhe në librin e numrave tregohet për një rit të ngjashëm.

Flaka (zjarri)

Nuk di a ke pasur ndonjëherë mundësinë e një kampingu veror. Nëse gjendesh në bjeshkët e largëta, është patjetër e nevojshme që të nderësh një zjarr, ku rreth teje bisedohet, këndohet edhe vallëzohet. Zjarri jo vetëm që ndriçon, por ai edhe nxeh, duke e krijuar një atmosferë të përqendrimit dhe të bashkësisë. Mundohu të medito: çfarë domethënie ka flaka apo zjarri i Shën Antonit?

Të kanë mësuar në shkollë, ose do ta mësojnë, zjarri prej thëngjillit në një ngrohtësi të madh i shkrin edhe metalet, ndërsa flaka e drurëve shërben për nxehje dhe për kuzhinë. Sa gjëra di të bëjë flaka apo zjarri! Flaka nxeh, djeg, ndriçon, pastron dhe është burim i energjisë.

Qysh prej kohërave më të lashta flaka është konsideruar si një gjë shumë e çmueshme. Nuk e di se a ke dëgjuar për Prometheun, heroin mitologjik, që ua kishte vjedhur flakën hyjnive për ta sjellë atë tek njerëzit. Dhe për këtë ishte dënur rreptsisht. Prej katër elementeve natyrore (ajri, zjarri, toka, e uji) flaka është konsideruar gjithmonë më i pa-

stërti. Pra, edhe element që më së shumti të afron afër shpirtit dhe fuqisë hyjnore.

Të ndalemi tani tek Shkrimi Shenjt. Po të tregoj një ngjarje që do ta nderë sadopak edhe fantazinë tënde. Kur Hyji iu shfaq Mojsiut në formë të një kaçube me zjarr në Malin Sinai (Dal 3, 2). E dëshiroj të sjell edhe mendjen tënde tek kaçuba



e zjarrtë, simbol i pranisë së Hyjit, që printe si një dritë, popullin e zgjedhur gjatë daljes në tokën e premtuar (Dal 13, 21-22). Çka mendon?

Pa dyshim, se për ne të krishterët momenti më domethënës janë Rrëshajët, apo zbritja e Shpirtit Shenjt mbi apostuj: Shpirti Shenjt zbrat me frymë të madhe dhe në forma të

gjühëve të zjarrit që vihen dalëngadalë mbi kokat e apostujve (Vap 2, 1-13). Ndër të tjera, edhe Shën Gjon Pagëzuesi kishte shpallur më herët: "unë po ju pagëzoj me ujë...Ai do t'iu pagëzojë me Shpirtin Shenjt e me zjarr" (Lk 3,16).

Shumë funksioneve të zjarrit shtojua edhe një: zjarri rinovon, ripërtërin! Ja çfarë mrekulie!

Gjatë liturgjisë ekzistojnë disa momente, jo edhe aq shumë, ku përdoret zjarri. Në mesë solemne ministratët e marrin kemin me thëngjill të nderur për të përhapur aromën e kemit. E pastaj ekziston një natë shumë solemne, Nata e Madhe e Pashkëve, ku bekohet zjarri i ri. Përpapa Kishës, përgatiten disa gaca të zjarrit dhe prej zjarrit ndizet edhe qiri i Pashkëve, që dërgohet në procesion deri tek altari. Flaka është simbol i fitores së dritës ndaj errësirës, të nxehtësisë ndaj ftohtësisë, dhe të jetës ndaj vdekjes.

Dhe në fund dëshiroj që ti të meditoesh edhe mbi këto fjalë të Jezusit: "Kam ardhur për të sjellë zjarrin mbi tokë, dhe sa dëshiroj që të jetë nderur flakë" (Lk 12, 49).

Kemi

Nëse ke qenë pak i kujdesshëm gjatë liturgjisë, ke pasur mundësinë të vërsh se aty përfshihet i tërë personaliteti ynë: shpirti dhe trupi. E di se ne kemi pesë shqisat: të pamurit, të dëgjuarit, të prekurit, të shijuarit dhe të nuhaturit. Deri edhe të nuhaturit merr pjesë në liturgjinë kishtare. Dhe për këtë po të flas, për kemin. Përpapa po t'i ve disa lajme historike.

Përdorimi i kemit është shumë i vjetër. Në disa regjione, për shkak të klimës atmosferike të nxehtë dhe për shkak të ajrit të rëndë, kemi shërbente për të përmirësuar dhe për të pastruar me substanca aromatike ajrin që e thithnin. Harrova të them se kemi përbëhet prej disa rrëshirave, që kur digjen, japin një aromë të pëlqyeshme duke e shpërndarë në ajër. Në ritet kushtuar të vdekurëve, shërbente për të treguar rrugën për në jetën tjetër dhe për të larguar edhe erën e rëndë të kufomës. Në disa raste kemi digjej edhe për të larguar shpirtat e këqij.

Por kostoja e madhe e rrëshirave aromatike ka bërë që përdorimi të jetë vetëm një privilegj i familjeve me mirëqenie të mirë sociale. Dhe nga këtu mund të bëjmë edhe hapin më të madh: kemi përdoret për të nderuar personalitetet e ndryshme. Të kemohet perandori, do të thoshte, tek romakët, ta njohësh sikur hyj. Edhe për këtë arsye, në tre shekujt e parë të krishterët evituan për-

dorimin e kemit gjatë liturgjisë. Aq më keq, në fillim kemi ishte edhe simbol i tradhtisë së fesë së krishterë (Apostazi), që shumë të krishterë që mos të mungojnë në këtë, preferonin të vdisnin si martirë duke e ruajtur fenë e vet.

Por me paqen dhe lirinë festare të Konstantinit (shekulli i IV), gjërat ndryshuan. Duke u fikur kulti ndaj perandorit, kemi hyrë dalëngadalë edhe në kultin e krishterë. Ndër të tjera, nuk duhet të harrosh se Hyji e kish të porositur edhe Moisiun që në mëngjes dhe në mbrëmje të digjeshin kemi me plot aromë mbi altar të vendosur në Tempull. Në ditën solemne të pastrimit (it. Espiazione) kryepriifti hynte në Shenjtin e Shenjtërve me gaca dhe kem për të "mbështjellë" me një re tymi dhe plot erëra të mira Arkën e Besëlidhjes, mbi të cilën besonin që pushonte Hyji, Jahve. Në fund, patjetër do të të bie ndër mend edhe për dhuratat e tre mbretërve, e ndër këto dhuratat veçohet edhe kemi. Edhe profeti Isaia veç kishte profetizuar se do të vinin prej lindjes disa mbretër dhe do të dhuronin kem në nder të Zotit.

Ja pra, tani pyetja me rëndësi: çfarë domethënie ka përdorimi i kemit në liturgjinë e krishterë? Me siguri ke marrë pjesë në një meshe solemne, dhe e ke parë meshtarin duke e kemosur altarin. Tymi i bardhë që del prej kemosës, çfarë të thotë? A nuk të përngjajnë me fjalët e meshtarit t'i naltojmë zemrat! Apo të gjitha

thirrjet tjera që janë të drejtura nga lart. Edhe psalmisti thotë këshu: "sikur tymi i kemit u ngjittë të ti lutja ime, duart e mia sikur flija e mbrëmjes" (Psalmi 141,2). Dhe jo vetëm kaq: kemi e krijon një atmosferë të pëlqyeshme dhe solemne, atmosferë gëzimi dhe feste. Mandej manifeston edhe nderimin ndaj një personi apo ndaj një simboli të Krishtit apo të kishës. Pra, kemosen Altarit, kryq, libri i ungjillit, dhuratat, dhe vetë meshtarit. Kemohen edhe besimtarët! Çfarë nder! Nderi i madh të jemi pjesëmarrës të flisë së shenjtë të Jezusit. E për sa i përket aromës, medito çka thotë Shën Pali: "Krishti e flijoi vetveten pors kush që jep erë të mirë" (Ef 5, 2). "Edhe në të njëjtën mënyrë të gjithë ne jemi të thirrur që të përhapim profumin e mirë të Krishtit" (shiko Kor 2, 14-16).

Tani më lejo që të tregoj kur ndodh përdorimi i kemit gjatë meshës. Në meshtë solemne, mund të përdoret në hyrjen e meshtarit në Kishë, më shoqërimin e ministrantëve me kem dhe kemosen. Për kemosjen e altarit dhe të librit të ungjijve para se të shpallet fjala e Zotit. Gjatë kushtimit të dhuratave, për kemosjen e Hostjes, Kelkut, Altarit, dhe të besimtarëve. Dhe në fund edhe kemosjen e Hostjes dhe të Kelkut pas shugurimit të tyre. Është e mundshme të përdoret kemi edhe gjatë liturgjisë së orëve, gjatë adhurimit dhe bekimit me të Shenjtueshmën Sakrament dhe në ritin e salikimit.

Përktheu nga italishtja: Don Jeton Thaqi





*Jam mik i Kishës Katolike
dhe dua ta ndihmoj
ndërtimin e Katedrales
"Nëna Terezë" në Prishtinë!*

Gjithë juve miq dhe bamirës
të dashur, ju mundësojmë ta
jepni kontributin përmes
xhirollogarive bankare.

Faleminderit!

X Raiffeisen BANK
Kosovo J.S.C.
Prishtina, Kosovo
SWIFT code: RBKORS22

Adm. Ap. e Prizrenit
Numri i llogarisë:
EUR: 1501 090000 1990 20
USD: 1501 090000 3765 30
CHF: 1501 090000 3764 33

Valuta	Banka	Shteti	SWIFT/BIC
EUR	Raiffeisen Zentralbank Oesterreich AG	Vienna, Austria	RZBAATWW
USD	American Express Bank, LTD	New York, US	AEIBUS33
CHF	UBS AG	Zurich, CH	UBSWCHZH80A

ABONONI "DRITËN"

Tash mund të jeni abonues të revistës kulturore të Kishës Katolike në Kosovë "Drita". Për vetëm 12 euro në vit (ose 1 euro për secilin numër), ne do t'ju dërgojmë **me postë** "Dritën" (vetëm brenda territorit të Kosovës).

Plotësoni formularin e mëposhtëm, dhe na e dërgoni bashkë me vërtetimin e pagesës në adresën tonë:
Rr. Gjon Pali II 1, 20000 Prizren.

Emri: _____

Mbiemri: _____

Adresa: _____

Qyteti: _____

Kodi postar: _____

Numri i telefonit: _____

E-mail: _____

Pagesa prej 12 eurosh mund të deponohet në Raiffeisen Bank Kosovo, në llogarinë 1502 0310 0086 0188. Ju lutemi, mos harroni ta futni fletëdeponimin në zarf bashkë me këtë formular. Ju faleminderit!

Për informata më të hollësishme, ju lutemi të na kontaktoni në numrin e telefonit: 029 241 933/14, me faks: 029 241 232 ose me email: revistadrita@hotmail.com ose revistadrita@yahoo.com.

Drita

Revista kulturore e Kishës Katolike në Kosovë

Edukimi dikur dhe sot

Duke përshkruar historinë e edukimit në Kosovë, nga kohët e lashta deri më sot, revista "Drita" ofron një panoramë të gjerë të kësaj teme. Në numrin e kësaj reviste, lexuesit do të gjejnë informata të reja dhe interesante për historinë e edukimit në Kosovë, nga kohët e lashta deri më sot. Revista "Drita" ofron një panoramë të gjerë të kësaj teme, nga kohët e lashta deri më sot. Në numrin e kësaj reviste, lexuesit do të gjejnë informata të reja dhe interesante për historinë e edukimit në Kosovë, nga kohët e lashta deri më sot.

Muzika shqiptare (vëzhgim i shkurtër)

Ispeshkëri nuk është ai që komandon, por ai që me jetën dhe me fjalën i përshpirtë.